

**24.05.2021
Ora 13:06**

RENDI I DITËS

Projektvendimi "Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 38, datë 09.05.2021 të subjektit ankues koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim PD-AN, për zonën zgjedhore Qarku Shkodër".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PD, LSI, PS

Z. E. Lako: Atëherë fillojmë, deklarojmë të çelur seancën e sotme për shqyrtimin e ankimit nr.38, subjekt ankues PD me objekt kundërshtimi i vendimit nr.342 datë 04.05.2021 për miratimin e tabelës përmbledhëse zonës zgjedhore Qarku Shkodër. Pavlefshmëria e zgjedhje të zhvilluara në datën 25.04.2021 si dhe urdhërimi për përsëritjen e zgjedhjeve Qarku Shkodër. Relator i kësaj seance jam zgjedhur unë, Elvin Lako sipas shortit të hedhur në datën 10.05.2021. Para se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes verifikojmë legjitimitimin procedural të palëve pjesmarrëse sipas nenit 133 të Kodit Zgjedhor. Është i pranishëm përfaqësuesi i subjektit ankues, zoti Logu.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po i nderuar, Marash Logu dhe Ivi Kaso janë përfaqësuesit prezent.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Logu ka ndonjë kërkesë depozituar për të qenë pjesë e procesit si palë e interesuar, zoti Sekretar i Përgjithshëm?

Z. Y. Merhaj: Pranë KQZ-së janë paraqitur 2 kërkesa, kërkesa e subjektit PS e cila kërkon të ndërhyjë në procedurë si palë e interesura dhe kërkesa e subjektit LSI e cila ka paraqitur kërkesë për ndërhyrje dytësore në këtë proces, faleminderit.

Z. E. Lako: Anëtarët e KAS-it në lidhje me këto kërkesa nga 2 subjekte keni dhe ju? Atëherë KAS i konsultuar në vend vendosi pranimin e këtyre 2 kërkesave nga këto 2 subjekte të interesuara për të qenë pjesë e procesit. Pyetje në lidhje me palët?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Nuk kemi i nderuar.

Z. E. Lako: Meqenëse nuk kemi kërkesa paraprake vazhdojmë me shqyrtimin e themelit të çështjes. Dy fjalë shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm në lidhje me objektin e ankimit.

Z. Y. Merhaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me Vendimin nr.342, datë 04.05.2021 ka miratuar tabelën përmbledhëse për zonën zgjedhore Qarku Shkodër për subjekte Zgjedhore dhe për kandidatë për deputet për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë së datës 25.04.2021 kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim subjekti zgjedhor PD duke mos qenë dakord dhe e ka bërë objekt të ankimit për shpjegime të mëtejshme mund të flasi vet ankimuesi.

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Sekretar i Përgjithshëm atëherë ftojme përfaqësuesit e subjektit ankues PD-AN për të paraqitur pretendimet e tij lidhur me çështjen faktet dhe provat ku i mbështet këto pretendime.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti kryesues i seancës, të nderuar anëtarë të KAS, PD në emër të Koalicionit PD-AN ka paraqitur Kërkesën Ankimore nr.38 datë 9.05.2021 duke kundërshtuar Vendimin nr.342 datë 04.05.2021 për miratimin e tabelës përmbledhëse për miratimin e rezultatit zgjedhor Zona Shkodër dhe pavleshmërinë e zgjedhjeve të 25.04.2021 dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve Qarku Shkodër. Ashtu siç jeni në dijeni në zgjedhjet e 25.04.2021, Qarku Shkodër, kanë marrë pjesë 113397 votues ose 41.8% në datat 26 dhe 27 prill është kryer numërimi i votave të subjekteve zgjedhore gjatë të cilit është konstatuar 107781 fletë të vlefshme dhe 6114 fletë të pavlefshme ose 5.3% e totalit të numrit të fletëve mandatët në këtë zonë zgjedhore janë ndarë: PD 5 mandate, PS 3 mandatë dhe PSD 2 mandate dhe LSI 1 mandatë. Në vijim i nderuar ashtu siç kemi pasur mundësi të relatojmë edhe kërkessat tona të mëparshme ankimor kërkesat tona kanë një strukturë të ngjashme sepse tipologjitë e shkeljeve që janë vërejtur nga ana jonë ngjasojnë në të gjitha qarqet e shqipërisë. Fillimisht do ndalemi tek shtylla e parë që ka të bëjë me blerjen evotës nëpërpjet personave me rekorde të tmerrshme krimilake. PS në Qarkun e Shkodrës kishte drejtues politik zotin Ilir Beqaj kandidatë për deputet në zgjedhjet e 25 prillit i renditur i 4 në listën shumë emërore të PS-së Qarku Shkodër. Zoti Ilir Beqaj është një person i cili është vendosur zyrtarisht nën akuzë nga prokuroria e posaçmë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në datën 5.02.2020 për korrupsion aktiv dhe pasiv, shpërdorim detyre dhe kontributeve të dhëna nga sheti si dhe përfitim të paligjshëm të interesave, aferave kriminale me koncesione PBP në

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

fushën e shëndetësisë. Nga ana tjetër drejtues i PSD-së në Qarkun Shkodër dhe kryetar i kësaj partie është shtetasi Tom Doshi i njohur në fakt dhe i përfshirë në raste madhore korrupsioni por edhe i përfshirë në krimin e organizuar. Këta shtetas në fakt bashkë me shtetat të tjerë përveç se janë hetuar, kallzuar në vitin 2017 për blerje të votës Qarku Shkodër edhe në këto zgjedhje kanë vënë në punë të njëjtën skemë kriminale nëpërmjet bashkëpunimit të tyre me individ të cilët kishin lidhje me krimin e organizuar. Në zgjedhjet e 25.04.2021 PSD e drejtuar nga shtetasi Tom Doshi fitojë 3 mandate në kuvendin e Shqipërisë përkatësisht 2 në Shkodër 1 Tiranë. 3 kandidatët për deputetë janë njëkohësisht anëtarë të PS dhe pjesë e administratës publike dhe dëshmon lidhjen që kjo parti ka pasur me pushtetin konkretisht shtetasi Gertian Dedaj është drejtor i ujesjellës kanalizime Kamëz, shetasja Meri Markiqi është drejtore agjensisë së formimit profesional dhe Gledis Çeliku drejtor i autoritetit rrugor Shqiptarë. Të nderuar anëtarë të komisionit ashtu siç kemi pasur mundësi të relatojmë dhe më herët PD ka denoncuar në vijëmisë pranë organeve të administratës publike konkretisht pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar rastet flagrante të shit-bletjes së votës. Në Qarkun e Shkodrës për rastet e shit-bletjes së votës dhe shkeljet e tjera flagrante që kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor PD ka depozituar 3 kallzime penale në SPAK gjatë dhe pas fushatës zgjedhore përkatësisht në datat 15.04.2021, 21.04.2021 dhe 6.05.2021. Konkretisht në datën 15.04.2021 PD ka kallzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Krimit dhe Korrupsionit të Organizuar për veprat e korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje për shpërdorim detyre për përdorim të funksionit për qëllime zgjedhore, për marrjen e mjeteve të identifikimit shtetatit si më poshtë: Shtetasi Benet Beci, kandidatë për deputeti renditur i treti në listën shumë emërore të PS në Qarkun Shkodër, shtetasi Tom Doshi kandidatë për deputet në Qarkun Tiranë dhe Shkodër

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

shtetasi Mark Frroku person me rekorde kriminale deputet i Kuvendit të Shqipërisë, shetasi Gjon Gjonaj kryetar i Bashkisë Pukë, shetasi Nue Luka, Lek Luka, Zef Luka, Vasil Muslija i cili ky i fundit është dhe drejtor i Hecit Fjerzë, shetasi Ndriçim Lasku punonjës i njësisë administrative në Bashkinë Pukë. Shetasi Martin Përdedaj administrator i njësisë administrative Qerret, Bashkia Pukë, shetasi Arben Guga këshilltarë në Bashkinë Pukë, shetatsin Florim Kolaj administrator i njësisë administrative Qelës, Sokol Frroku shoferi kryetarit Bashkisë Pukë, Dritan Frroku, Dake Hajdari si dhe shtetas të tjerë të cilët nga denoncimet dhe informacionet indicjet e marra nga strukturat e PD-së janë përfshirë në skemat kriminale të blerjes së votës gjatë zgjedhjeve të 25 prillit. Më tutje të nderuar në datën 21 prill 2021 PD ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit të Organizuar shtetasit Fran Tuci kryetar i bashkisë Fushë-Arrëz, shetasin Albert Tuci vëllai i kryetarit të bashkisë, shetasi Ardian Marku shef i policisë bashkiake Fushë Arrëz, shetasin Anel Gjinaj shef i urbanistikës, shetasin Bardhok Jaku administrator i Njësisë administrative Fierrëz, shetasin Gjon Gjonaj kryetar i bashkisë dhe shtetasja Lule Mema administratore në njësinë administrative Rrapë. Të gjithë këta shtetas të skeduar të denoncuar të kallxuar për veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje të shpërdorimit të detyrës të shpërdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore. Nga ana tjetër PD po ashtu ka kallzuar disa shtetas të tjerë që po ashtu janë përfshirë në veprat penale që kanë cënuar procesin zgjedhor dhe konkretisht korrupsion aktiv dhe pasiv në zgjedhje, shpërdorim të detyrës mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve shpërthyesë dhe municionit si dhe të gjitha këto të kryhen në vlerësimin tonë në formën e grupit të strukturuar kriminal. Për këtë në datën 21 prill PD ka kallzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar shetatsin Edi Rama me detyrë kryetar i PS-së dhe kryeministër i Shqipërisë, shetasin Frrok

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Gjini kandidatë për deputetë i renditur i 5 në listën shumë emërore të PS Qarku Shkodër, shtetasin Niko Ibrahimaj drejtor i Policisë Qarku Shkodër, shetasi Ilir Baba drejtor i ujësjellës kanalizime bashkia Vau- Dejës, shtetasi Basri Baba person me rekorde të rënda kriminale te cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë kryer vepra penale të shit blerjes së votës. Të nderuar anëtarë të komisionit shit blerja e votës ishte një nga proceset më të rënda që karakterizojë procesin zgjedhor të 25 prillit, në qarkun eshkodrës persona me rekorde të rënda kriminale në bashkëpunim me kandidatët për deputetë të PS dhe PSD të drejtuar nga shtetasi Tom Doshi kanë zbatuar një skemë kriminale të blerjes së votës me 100 Euro vota. Në krye të skemës kriminale të shit blerjes së votës në Qarkun e Shkodrës qëndron shtetasi Benet Beci kandidatë për deputet i renditur i 5 në listën shumë emërore të PS dhe njëkohësisht drejtor i korporatës elektro energjitike shqiptarësi dhe shetatsi Tom doshi deputet i kuvendit të shqipërisë dhe kryetar i PSD, shetasi Mark Frroku person me rekorde të rënda kriminale. Këta shetas në bashkëpunim me njëri tjetrin janë parë shpesh herë të ndajnë funksione dhe pozicione të caktuara për administratën publike por gjithashtu edhe të bashkëpunojnë me njëri tjetër që më pas janë skeduar për veprimtari të blerjes së votës. Në Pukë dhe Gjegjaj mark Frroku është personi kryesor për blerjen e votave një person më rekorde të tmerrshme kriminale i cil ka përdorur dhe në këto zgjedhje si dhe të vitit 2013, 2015, 2017 në Gjegjaj skema kriminalë e blerjet së votave është drejtuar nga shtetasi Mark Frroku dhe shpërndarja e parave nga familja Luka, në pukë skema kriminale e blerjes së votës është organizuar nga Mark Frroku dhe Benet Beci dhe shpërndarja e parave është kryer në ambientin Oda e Kabashit me pronar dhe shpërndarës shetatsin Dritan Frroku në lokalit në pronësi të familjes Hajdari, ku rolin e shpërndarësit e luante zonja Dake Hajdari Curraj, e cila ka lidhefamiljare me Mark Frrokun. Nga ana tjetër në zonën e Fjerzës skema kriminale e blerjes së

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

votave është drejtuar nga shtetasi Benet Beci në cilësinë e drejtorit të KESH dhe Vasil Muslija më detyre drejtori i HEC Fjerëz. Në Bashkinë Fushë Arrëz skema kriminale blerjes së votave dhe shpërndarjes së parave është drejtuar dhe organizuar nga vetë shetasi Tom Doshi, i cili ka shpërndarë para nëpërmjet shetasve Shkurt Lasku, Ndricim Lasku apo edhe Dritan Frroku. Në Qerrët skema kriminale e blerjes së votave është drejtuar dhe organizuar nga Mark Frroku ndërsa shpërndarës kanë qenë shetasit Martin Përdedaj i cili është dhe drejtues i njesisë administrative Qerret. Në Çeles po ashtu i nderuar, shetasi Mark Frroku ka drejtuar dhe organizuar veprimtarinë kriminale të blerjes së votave nëpërmjet shetasve Florik Kolaj, Arben Guga dhe Sokol Frroku. Ato që ne sollëm dhe parashtruam përpara këtij komisioni tregojnë fakt se skema e shit blerjes së votës ishte skemë e mirëfilltë kriminale nëpërmjet grupeve kriminale, pra ka drejtues shpërndarës ka njerëz që financojnë këto veprimtari kriminale. Për të gjitha këto raste ne nuk kemi mbetur vetëm në kuadrin e konstatimeve apo denoncimeve, të dhënave apo indicieve por PD, në mënyrë të përsëritur në të paktën 3 raste ka denoncuar ka depozituar kallzim penal pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Ne jemi të bindur se nqs nga ana juaj do të kryej një hetim i plotë dhe i gjithanshëm të dhënat që ne sapo cituam do dëshmojnë për një aktivitet gjerësisht të përhapur të shit blerjes së votës në Qarkun Shkodër i cili ka diktuar vullnetin e zgjedhësve në zgjedhjet e 25 prillit përndryshe nuk mund të shpjegohet ndryshe i nderuar, se si në vitin 2013 në zgjedhjet parlamentare PSD e drejtuar aktualisht nga shtetasi Tom Doshi ishte një parti inekzistente që nuk arrinte të merrte më shumë sesa 100 vota, në zgjedhjet e 2017 morri 13000 dhe në këto zgjedhje morri vota të mjaftueshme për të prodhuar 2 mandate deputetësh. Ndoshta këtu duket normale që shtetas të cilët kanë ushtruar aktivitete të paligjshme dhe kriminale nëpërmjet financimit të personave të caktuar

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

sjellin deputetë në Kuvendin e Shqipërisë por ne besojmë ky është rasti që duhet të ngrejmë alarmin për çdo institucion dhe organ publik të këtij shteti të kësaj republike. Nga ana tjetër ashtu siç kemi pasur mundësi të relatojmë edhe në qarqet e tjera blerja e votës nuk u realizua thjeshtë dhe vetëm nëpërmjet dhënies së parave apo të mirave materiale por edhe shpërblimeve bonusve apo dhe përfitimeve të tjera që vin si rezultat i veprimatri shtetërore. Ne kemi cituar disa nga ato vendime të këshillit të ministravë por dhe të organeve lokale që kanë sjellë një përfitim të drejtpërdrejtë për kategori të caktuara shoqërore e cila në fakt është në shkelje të nenit 91, pika 4 dhe 5 të Kodit Zgjedhor. Nga ana tjetër të nderuar edhe në Qarkun Shkodër u konstatua sesi i gjithë shteti u vendos në shërbim të PS duke përdorur për këtë qëllim tenderat dhe prokurimet publike për individë më rekorde krimilale të cilët duhet të ofronin mbështetjen etyre politike ndaj PS-së. Është rasti edhe këtu që të sjellim në vëmendjen tuaj edhe kontratat publike në vitin para zgjedhor 2020 u pesëfishuan në numër dhe në vlerë krahasuar me 5 vitet e fundit që nuk kishte pasur një numër kaq të lartë kontratash. Plot 875 kontrata publike me vlerë 505 milion euro dëshmojnë se buxheti i shtetit, paratë e taksapaguesve shqiptarë u vendosën në dispozicion të PS-së. Shteti u vu në fakt në dispozicion të PS-së për të marrë përkrahjen e personave me rekorde të tmerrshme kriminale që mbështetën PS me financime të paligjshme PS-në përgjatë fushatës. Konkretisht shtetasi Pëllumb Gjoka është person me rekorde të rënda kriminale, një nga trafikantët më të fuqishëm të drogës në zonën e Velipojës dhe bashkëpuntorë i Bandës së Bajrave. Ky është një person i cili edhe në vitin 2017 dhe 2019 është denoncuar në mënyrë të përsëritur për përfshirjen e tij në fushatë zgjedhore të PS-së. Në nëntor të 2020 ky shtetas nëpërmjet shoqërisë së tij Frozen shpk ka përfituar nga Bashkia Tiranë nga Kryebashkiaku Erjon Velia 4 tendera me vlerë 1.6 milion euro gjithashtu nëpërmjet shoqërisë Imperial Group ai ka përfituar dhe

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

leje ndërtimi për ndërtimin e një kompleksi turistik në zonën e Velipojës. Pra i nderuar këto vakte dhe ne kemi pasur mundësinë të depozitojmë dhe provat përkatëse dëshmojnë se si individë me rekorde të tmerrshme kriminale të cilat kanë fituar biznese me burime të paligjshme përfitojnë tendera dhe prokurime publike dhenjë pjesë të këtyre parave që i marrin nga buxheti i shtetit i vendosin në funksion të veprimtarisë kriminale të një partie siç është rasti i kësaj rradhe i PS-së apo PSD-së. Ne i nderuar në faqen 9 kemi shpjeguar në mënyrë të detajuar se si lejet dhe kontrata publike që i janë dhënë këtij shetasi Pëllumb Gjoka janë plotësisht në kundërshtim dhe shkelje flagrante të ligjit. Ne ashtu kemi shpjeguar sesi shteti vendosi të gjitha investimet publike në funksion të PS-së për zgjedhjet e 25 prillit. Kryeministri, ministrat, deputetët dhe kryetrët e bashkisë Socialist përdorën investimet publike për propagandë politike në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet ligjore të nxjerra nga KQZ-ja. Në 24 raste për të cilat PD-ja ka paraqitur foto dhe video ndër të cilat deputetët e PS-së Edi Rama, Benet Beci, Ilir Becaj dhe Milva Ikonimi promovuan investimet publike me qëllime elektorale në Qarkun e Shkodrës. Përdorimi i burimeve shtetërore, vendosja e të gjithë aseteve publike në shërbim të partisë në pushtet është një fakt i evidentuar edhe në raportin paraprak të OSBE-ODHIR të cilin nuk po e citoj sepse palët kanë pasur mundësinë të njihen. Është fakt publik se dhe në Qarkun e Shkodrës ashtu si dhe në qarqet e tjera administrata u intimidua u kërcënua u vendos nën presion më qëllim e vetëm që të mbështeste PS-në. Atyre ju kërkua konkretisht që të përfshiheshin në fushatë për PS-në, të sillnin lista me 30-40 votues të sillnin kartat e tyre të ID si dhe të jepnin përfitime të tjera për mbështetës dhe simpatizantë të PS-së. Nga ato që ne kemi pasur mundësi që t'i administrojmë dhe t'i vëmë në dispozicion, nënpunës të niveleve të ulta dhe të mesme të adminstratës në Shkodër, Malsi të Madhe, Pukë, Fushë - Arrëz kanë

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

denoncuar presionin e vazhdueshëm që patën nga eprorët e tyre për ta vënë gjithë aktivitetin në shërbim të PS-së. E di i nderuar që ndoshta nuk është qarku ku duhet bërë kjo gjë por dua ta theksojë dhe ta themi deri në fund, në çdo proces që në këtë sallë që jemi sot ne patëm një proces rinumërimi për Qarkun e Beratit dhe gjithë vëzhguesit që solli subjekti zgjedhor PS ishin punonjës të Bashkisë Berat. Pra, në dy ditë punë dita e enjte dhe e premte gjithë vëzhguesit e PS-së, është një informacion që mund të verifikohet emër pas emri, kishin braktisur vendet e punës dhe ishin duke kryer një funksion politik siç është vëzhguesi i një partie politike. Kjo në fakt nuk është një rast i izoluar por është rasti që ka ndodhur në të gjitha qarqet përfshirë këtu edhe Qarkun Shkodër.


*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ne i nderuar kemi pasur mundësinë të relatojmë përpara këtij komisioni duke besuar në drejtësinë e vendimmarrjeve të tij, se si në vetëm katër muaj administrata publike u shtua me 13 mijë punonjës. Nga ana tjetër është fakt publik, i cili mund të jetë lehtësisht i verifikueshëm edhe nga të dhënat e thesarit të shtetit se vetëm në periudhën Janar – Prill 2021 u paguan vetëm rreth 63 milion euro më shumë paga, seç ishin paguar në të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Nuk asnjë dyshim që kjo rritje e jashtëzakonshme lidhet drejtëpërdrejtë me faktin që administrata publike u shëndërrua në një vend punësimi për militantët dhe mbështetësit e Partisë Socialiste. Nga ana tjetër i nderuar ne kemi relatuar fakte të rëndësishme që kanë pasur të bëjnë me ndihmat ekonomike se si në periudhën Janar- Prill 2021 shteti shpërndau rreth 2.6 milion euro më shumë se çkishte shpërndarë në të njëjtën periudhë të vitit 2020. Po ashtu rreth 1.7 milion euro u shpërndanë si paga luftë nga ana e Ministrisë së Financave në periudhën zgjedhore. Të gjitha këto fakte dhe të dhëna ne i kemi kërkuar në mënyrë të përsëritur që të evidentohen qark pas qarku se sa është masa e tyre. Pra edhe në Qarkun Shkodër ashtu si dhe në qarqet e tjera i nderuar vlejné kërkesat tona për marrjen e provave që kanë të bëjnë me evidentimin e saktë për të kuptuar përmasat reale se sa është numri i të punësuarve në periudhën Janar-Prill 2021 në Qarkun e Shkodrës. Sa është numri i pagave dhe shpërblimeve që morën këta punonjës punësuar rishtazi? Sa është numri i familjeve apo personave që u përfshinë në ndihmën e skemës ekonomike? Sa është masa dhe se si ndryshojë masa ekonomike në Qarkun e Shkodrës? Sa paga lufte u shpërndanë në Qarkun e Shkodrës gjatë kësaj periudhe? Të gjitha këto të dhëna do t'i shërbënin këtij komisioni, do t'i shërbënin palëve ankuese apo palëve të interesuara, po sigursht edhe publikut për të kuptuar se si buxheti i shtetit, taksat e qytetarëve Shqiptarë, u vendosën në fakt në dispozicion të Partisë Socialiste edhe në Qarkun e Shkodrës.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Ne i kemi relatuar, shpjeguar, dhe paraqitur përpara këtij komisioni në mënyrë të përsëritur faktin se si lejet e legalizimit dhe lejet e ndërtimit u përdorën si një mjet efektiv për të blerë vota në favor të Partisë Socialiste. Për këtë kemi sjellë si shembull një nga ato që mund të konsiderohet si skandali më i madh në fakt i këtyre zgjedhjeve do të ishte i tillë në çdo shtet dhe republikë normale, që kishte të bënte me audio përgjimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Kadastrës që flistë për rreth 160 mijë leje legalizimi që duhet të përdreshin varësisht sipas nevojave politike që kishte Partia Socialiste. Është për turpin e këtij shteti dhe sigurisht kjo nuk iu takon ju për t'a shqyrtuar po sigurisht që duhet thënë nga njëri, nga ana jonë e kemi detyrim. Që një drejtor i cili për të cilin është publikuar një audio përgjim i tillë, vazhdon edhe sot të jetë në detyrë dhe i pa shqetësuar. Ne e kemi relatuar dhe e kemi paraqitur përpara këtij komisioni të nderuar se si të dhënat personale të qytetarëve u morën nga serverat shtetëror, u vodhën më mirë të themi dhe më pas u përdorën nga strukturat e Partisë Socialiste, për të ndikuar mbi vullnetin e zgjedhësve. Nuk e themi ne po e ka thënë dhe raporti paraprak i OSBE/ODIHR edhe deklarata e misionit të Shteteve të Bashkuara në OSBE se rrjedhja e të dhënave personale dhe përdorimi i tyre nga ana e një partie politike siç është rasti i Partisë Socialiste i bën zgjedhësit më vulnerabël në raport me shprehjen e lirë të vullnetit të tyre. Nga ana tjetër ne i nderuar kemi relatuar dhe shpjeguar në mënyrë të gjërë përpara këtij komisioni faktin se si ndalimi i 500 mijë emigrantëve me të drejtë vote në Republikën e Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut për të votuar ndikoi drejtëpërdrejtë në rezultatin zgjedhor në të gjithë qarqet e Shqipërisë e sigurisht dhe në Qarkun e Shkodrës. Ne do kërkojmë në mënyrë të përsëritur ashtu siç kemi bërë që ju të merrni ato prova të cilat do vërtetojnë se sa janë përmasat reale të këtij ndikimi në Qarkun e Shkodrës. Nga ana tjetër ne i nderuar kemi relatuar përpara këtij komisioni se fakti që pati një vendimmarrje në vlerësimin tonë, në

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

kundërshtim me nenin 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, çojnë në fakt në numrin më të madh të fletëve të votimit që kanë ndodhur ndonjëher në të gjithë Republikën e Shqipërisë e veçanërisht në Qarkun e Shkodrës, ku numri i fletëve të votimit është 6114 fletë votimi të pavlefshme ose rreth 5.3%. Duhet thënë i nderuar se diferenca ndërmjet Partisë Demokratike dhe Partisë Social Demokrate për mandatin e 6 –të për PD-në dhe mandatin e dytë për këtë forcë është rreth 2 mij e 74 vota çka provon se në qoftë se vullneti i këtyre zgjedhësve nuk do të ishte bërë i pavlefshëm me siguri edhe rezultati mund të ishte i ndryshëm. Nga ana tjetër edhe në këtë proces i nderuar ne kërkojmë në mënyrë të përsëritur që të merren dhe të administrohen, të bëhen nga pajisjet e identifikimit elektronik pasi nga informacionet që ne kemi marrë në zonat e ndryshme të Qarkut Shkodër veçanërisht në zonat rurale ka pasur raste të përsëritura të votimit të shumëfishtë, votimit familjar apo votimit për të tretët. Në konkluzion të parashtrimeve tona i nderuar qëndron fakti ose qëndrojnë dy fakte shumë të rëndësishme që duhen pasur vazhdimisht parasysh nga ana e këtij komisioni. Së pari shitblerja masive e votës në Qarkun e Shkodrës, e cila jemi të bindur që ka diktuar minimalisht dy mandate dhe veçanërisht rezultatin zgjedhor të Partisë Social Demokrate të drejtuar nga shtetasi Tom Doshi, por sigurisht edhe mandatet e kandidatëve të Partisë Socialiste. Ne i kemi denoncuar dhe i kemi ngritur vazhdimisht qoftë edhe nëpërmjet kallëzimeve penale, apo edhe indicie dhe prova të tjera, që iu kemi vënë në dispozicion se si shtetasi Benet Beci, i cili ishte drejtori i Kooperatës Energjitike Shqiptare, vuri të gjithë administratën, të gjitha burimet publike që kishte kjo administratë në shërbim të fushtës elektorale të Partisë Socialiste në Qarkun e Shkodrës. Nga ana tjetër ashtu siç patëm mundësi të relatojmë, dhe të shpjegojmë gjerësisht nuk ka asnjë dyshim që edhe në Qarkun e Shkodrës shteti u

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

vu në dispozicion të Partisë Socialiste, shteti dhe partia në pushtet u shkrinë në një të vetme. Ky nuk është veçse një konstatim i një partie politike të cilit sigurisht e shqetëson kjo çështje pasi nuk ka parti politike në asnjë shtet dhe shoqëri demokratike që mund ti kundërvihet shtetit dhe sigurisht që këto ishin zgjedhje krejtësisht të pabarabarta por është fakt publik që edhe shefja e misionit OSBE/ODIHR deklaroi në një konferencë paraprake se më problematike se shitblerja e votës në fakt ishte fakti se shteti dhe partia patën linja shumë, pati një linjë shumë të hollë, që ndau shtetin dhe partinë çka në vetvete nënkupton se shteti vuri të gjitha asetet dhe burimet e saj në përdorim të Partisë Socialiste. Doja i nderuar që t'a mbyllja këtë parashtrim paraprakë, duke thënë që ne kemi depozituar të gjitha ato prova që ne kemi pasur në dispozicion, po nuk ka dyshim se edhe në këtë rast zbardhja e plotë e masakrës zgjedhore të 25 Prillit në Qarkun e Shkodrës do varet pikërisht nga vullneti juaj për të marrë ato prova që PD-AN kanë kërkuar, faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit, zoti Logu! Zoti Kaziaj në cilësinë e ndërhyrësit, apo i qëndroni këtyre pretendimeve.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zoti Lako. Ne i qendrojmë plotësisht pretendimeve të subjektit politik Partia Demokratike. Të gjitha ato që relatoi zoti Logu, përsa i përket pjesës së paligjshmërisë përpara procesit, gjatë, dhe post proces janë të gjitha të faktuara tanimë, dhe të themi nëpërmjet dokumentave zyrtar. Qëndrimet e mbajtura nga institucionet ndërkombëtare dhe ato kombëtare dhe të themi të materialit të nevojshëm në dispozicion qoftë edhe të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nëpërmjet denoncimeve të bëra në rubrikën e posaçme të ndërfaqes në faqen e internetit të KQZ-së. Po ashtu janë referuar siç

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

tha zoti Logu, pranë organeve kompetente të gjitha ato gjetjet e bëra nga subjekti politik Partia Demokratike por edhe nga ana jonë, paligjshmëria ka qenë aq e madhe në Qarkun e Shkodrës sa që në një ndërthurje midis grupeve kriminale dhe institucioneve shtetëore ka ardhur ky rezultat që të gjithë ne jemi në dijeni. Themi që jemi dakord me çdo gjë që relatoi Partia Demokratike, faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Kaziaj! Të lutem zoti Salianji!

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Faleminderit! Përsa i përket kërkesës ankimore të relatuar. Kjo kërkesë nuk gjen asnjë zbatim në dispozitat e Kodit Zgjedhor. Kërkesa për pavlefshmëri siç ne e kemi theksuar, kërkon, së paku nga ana formale kërkohet pavlefshmëria në një osë në disa nga QV. Në kërkesën e relatuar nuk u pa edhe gjatë seancës, nuk u kërkua nga Partia Demokratike të shpallen të pavlefshme një apo disa qendra, po u kërkua i gjithë Qarku i Shkodrës. Këtë ligji nuk e njeh, nuk e njeh ligji pavlefshmërinë e një qarku por pavlefshmërinë e një apo disa qendrave. Të cilën e lidh me shkeljet që ka ndodhur në këto qendra. Do të thotë që shkelja nuk ka ndodhur, prandaj nuk është kërkuar edhe pavlefshmëria në qendra të caktuara përsa i përket votimit të ndodhur në Shkodër. Kjo është përsa i përket anës formale, përsa i përket thelbit dhe deklarimeve të bëra në seancë siç ne e kemi theksuar këto janë deklarime politike në kufijtë e shpifjes. Kaq kisha, faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Salianji! Nga anëtarët e KAS-it ka ndonjë pyetje për sa dëgjuam përsa u parashtrua këtu përpara nesh. Atëherë, mesa duket nuk ka asnjë pyetje. Mund të vazhdojmë me administrimin e provave të paraqitura, pretendimet,

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

prapësimet lidhur me këto prova, dhe kërkesat eventuale që mund të ketë për provat e reja sipas rradhës po zoti Logu.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po, faleminderit zoti Lako! Provat janë depozituar nga ana jonë. Në qoftë se është , mesa po kontrolloj materialin mbase ka ndodhur ndonjë gabim teknik që nuk janë cituar po themi në fund. Në qoftë se është e nevojshme po e citojmë me rradhë apo e vlerësoni ju, që provat duke qenë se janë të depozituara...

Z. E. Lako: Nëse janë të njëjta me rastet dhe me këto çfarë ju relatuat, mundet t'i dorëzoni me shkrim pranë administratës, si t'a dëshironi.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Nga komunikimi që kam pasur me administratën ne do të dorëzojmë një listë të themi të provave që janë tashmë dorëzuar dhe depozituar pranë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve dhe mbase nuk është, për ekonomi kohe që mos t'i lexojmë një për një të gjitha atyre provave. Por vlerësojeni ju!

Z. E. Lako: Në rregull, për ne është në rregull.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Nga ana tjetër i nderuar duke qenë në vijim se këto proceset ankimet që Partia Demokratike ka depozituar pranë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve vlerësojmë se janë të lidhura me njëra tjetrën. Megjithëse vendimmarrja juaj do jetë për secilën prej tyre ashti siç janë edhe faktet dhe grupfaktet për secilën më vete. Në seancën gjatë sëcilës u shqyrtua kërkesa ankimore e Partisë Demokratike për Qarku e Durrësit, u tha që subjekti ankues nuk

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

ka bërë përpjekje për të siguruar vetë provat të cilat i duheshin asaj për të provuar të gjitha pretendimet e ngritura në këtë proces. Prandaj unë kërkoj që në këtë proces të dorëzoj 100 kërkesa që Partia Demokratike u ka dërguar me datën 15 Maj 2021, 100 institucioneve publike të Republikës së Shqipërisë. Provat janë, kërkesat janë këtu.

Z. E. Lako: Mund t'i dorëzoni, ne do të administrojmë provat, do të shprehemi me vendim edhe për këto. Faleminderit!

Z. M.Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord!

Z. E. Lako: Zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Lidhur me provat qendrimi ynë, i nderuar zoti Lako është ai që sapo përfaqësuesi i PD-AN saktësoi. Do ishte mirë nuk e di që nuk e di zoti Logu cilësoi pjesën e marrjes së informacionit përsa i përket pjesës së PEI-t siç është bërë në të gjitha kërkesat ankimore le të themi. Në qoftë se e ka brendësi të kërkesës patjetër që ndajmë të njëjtin qendrim. Po ashtu edhe atë që në pjesën e fundit të fjalës së tij ai saktësoi lidhur me marrjen e provave nga të tretët që është një domosdoshmëri se flasim për një kërkesë ankimore të re le të themi. Ju jeni relatori për Qarkun e Shkodrës në këtë rast, por edhe në qarkun e mbledhjes së mëparshme që ishte Qarku i Durrësit. Është kërkuar kjo, ju nuk e keni vlerësuar të nevojshme le të themi me tre votat e anëtarëve të shumicës. Gjithsesi është një kërkesë procedurale që e parashikon edhe Kodi Zgjedhor dhe Kodi i Procedurës Civile, nuk kemi pasur mundësi për të aksesuar në këto prova ndaj është bërë edhe kërkesa e zotit Logu. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Kaziaj! Përfaqësuesi i palës së interesuar subjekti Partia Socialiste, nuk është në sallë. Atëherë, KAS për të administruar këto kërkesa dhe provat e paraqitura, do të tërhiqet në dhomë këshillimi për vendim. Në orën 14:00 riçelim seancën.

Rifillon Mbledhja

Ora 14: 04

Z. E. Lako: Atëherë, në lidhje me administrimin e provave, KAS me vendim të ndërmjetëm vendosi që të administroi provat e paraqitura nga subjekti Partia Demokratike, në emër të koalicionit PD-AN ashtu siç janë paraqitur. Në lidhje me kërkesën për marrjen e 19 provave kërkesave të reja me shumicë votash vendosi rrëzimin e saj, për shkaqe të cilat janë bërë publike. Do të pasqyrohen përsëri në vendimin përfundimtarë me gjithë shpjegimet e duhura. Ndërsa dy anëtarë të KAS bazuar në nenin 136 pika 3 të Kodit Zgjedhor kërkuan të administrohet si provë të dhënat e kryeqëzuara nga pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve për zonën zgjedhore Qarku Shkodër për të bërë të mundur evidentimin nësa ka raste të votimit të dyfisht ose familjar. Lidhur me këtë kërkesë zoti Sekretari i Përgjithshëm ku jemi me sigurimin e kësaj prove?

Z. Y. Merkaj: Besoj për një orë janë gati, kryqëzimi i të dhënave.

Z. E. Lako: Atëherë, subjektet ankues sa kohë ju duhet në dispozicion për t'u njohur dhe për të...

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kisha vetëm një pyetje nëse mundem. Në administrimin e provave që pranuat, u pranuan edhe kërkesa që ne depozituam sot? Pra, 100 kërkesat për informacion që iu kemi drejtuar institucioneve publike?

Z. E. Lako: Ai është një informacion që ne u njohëm dhe i administruam dhe janë pjesë e dosjes. Si kërkesa që ju keni bërë pranë institucioneve ...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Nuk ka nevojë për debat, thjesht kërkuam të dimë, po ose jo? Po! Dakord, nuk ka asnjë kundërshtim. Nuk ka nevojë të prodhojmë debat. Ne i nderuar vlerësojmë po themi që pasi të marrim edhe provat që janë kërkuar të shtyhet që eventualisht nesër të kemi edhe mundësinë domethënë duke qenë se nuk ka as kërkesa të tjera as nga subjektet e tjera. Që të paraqesim pretendimet tona përfundimtare mbase nesër t'i japim fund.

Z. E. Lako: Atëherë, ju kërkonit që seancën t'a lëmë për nesër?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Mendoj që t'a lëmë nesër që të kemi kohën e nevojshme për të parë materialet.

Z. E. Lako: Edhe ju zoti Kaziaj besoj?

Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së: Po, po zoti Lako, duke parë që është një proces dinamik dhe ne sot e kemi filluar në orët e para të ditës këtë proces themi, ndonëse kërkesat ankimore kanë qenë shumë se 1. Do të donim edhe ne t'i jepnim rëndësinë e mjaftueshme nëpërmjet kohës së mjaftueshme për të dhënë ato që janë pretendimet tona, pasi të njihemi me provat.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Kaziaj! Atëherë, përfaqësuesi i palës së interesuar Partisë Socialiste nuk është në seancë, me kërkesën tuaj dhe KAS i konsultuar vendosi që t'a kalojmë për nesër vazhdimin e kësaj seance. Në mënyrë që edhe ju të njiheni dhe të bëni prapësimet tuaja me pretendimet përfundimtare në lidhje me këtë çështje. Atëherë, meqenëse edhe me këtë çështje për sot i dhamë zgjidhje. Çështja në rradhë është ankesa e subjektit të kandidatit të pavarur për Qarkun e Tiranës dhe i PD-së. Por meqenëse nuk është njoftuar për këtë seancë dhe nuk është në sallë, do të dojë kohën e nevojshme besoj që të njoftohet për nesër nga administrata në orën 10:00. Ndërkohë nesë jeni gati, meqenëse ju jeni, për Qarkun e Elbasanit zoti Logu?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: I nderuar pavarësisht domethënë se mirëkuptojmë edhe faktin që këto kërkesa parimisht duhet të shqyrtohen në një kohë të shkurtër. Mendojmë që secila kërkesë dhe secili proces të marrë rëndësinë dhe vëmëndjen e duhur. Kështu që do kërkonim edhe mirëkuptimin tuaj në mënyrë që edhe ne po themi të bëjmë gjithë përgatitjen e nevojshme që shqyrtimi për Qarkun e Elbasanit dhe ndonjë qarku tjetër që është në rradhë siç është po themi e përcaktuar nga ana e këtij komisioni të kryhet gjatë ditës së nesërme. Ditën e nesërme ne do kemi thjesht besoj pretendimet përfundimtare lidhur me Qarkun e Shkodrës. Mbase na vjen po themi edhe informacioni kërkuar edhe për Qarkun e Durrësit. Kështu që nuk ka asnjë lloj pengese që më pas të vazhdojmë me Elbasanin. Qarku i Elbasanit ne kemi evidentuar një numër të konsiderueshëm shkeljesh dhe do të donim që të merrte vëmëndjen e duhur. Pra edhe ne kemi nevojë që të na lihet një kohë e caktuar në dispozicion.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. E. Lako: Atëherë, KAS u konsultua dhe vendosi që orën 10:00 nesër që të fillojmë me Qarkun e Tiranës. Dhe ndërkohë nëse do të kemi mundësi do të vazhdojmë edhe me këto qarqet e tjera në vijimësi të zgjatjes dhe në vijimësi të procesit. Dakord, që për këto qarqet që për sot kemi filluar të paktën të jemi të përgatitur. Në mënyrë që të ecim me procesin mos të kemi më ndërpreje.

Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së: Meqë u la pjesa e Qarkut të Shkodrës për kalim për nesër, për njohjen e provave, bërjen besoj të pretendimeve përfundimtare fillimisht. Besoj do jetë një proces deri diku i shkurtër, bëjmë atë? Çgfarë mendimi ka KAS këtë rradhë?

Z. E. Lako: Patjetër, gjithmonë duke ndjekur rradhën e këtyre çështjeve që janë, dhe në qoftë se do të kemi mundësi, do të vazhdojmë edhe me të tjerat që janë në rradhë. Kështu që të përgatitemi për sa mundemi. Atëherë, këtë seancë e deklaroj të mbyllur dhe takohemi nesër në orën 10:00 me Qarkun Tiranë, faleminderit!

RENDI I DITËS

Projektvendimi "Shqyrtimi i kërkesave ankimore nr. 37, datë 09.05.2021 të subjektit ankues Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim PD-AN dhe nr. 46, datë 09.05.2021 të subjektit ankues Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore Qarku Durrës".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PS, PD, LSI

Z. K. Bele: Mirëmëngjes të gjithëve! E deklarojmë të çelur seancën e sotme për shqyrtimin në themel të ankimit nr.37 të subjektit ankues Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, me objekt: Kundërshtimin e vendimit nr.340, datë 04.05.2021 për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore, Qarku Durrës, pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara, në datën 25.04.2021 dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Qarkun Durrës, si dhe ankimi nr.46 të subjektit ankues, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim me objekt: Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr.340, datë 04.05.2021 për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit, Qarku Durrës dhe rinumërim dhe rivlerësim të votave në të gjitha ZAZ-të e Qarkut Durrës. Relatori i kësaj çështjeje sipas shortit jam zgjedhur unë, Koli Bele. Shorti i hedhur në datën 10 maj me vendimin e ndërmjetëm nr.81, KAS vendosi shqyrtimin

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*


bashkëlidhur të këtyre 2 kërkesave ankimore. Verifikojmë legjitimitimin procedural të palëve pjesëmarrëse. Janë subjekti ankues të pranishëm? Konstatojmë që subjekti ankues Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste është prezent. Ndonjë kërkesë nga subjekte për të qenë palë e procesit?

Z. Y. Merhaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka bërë kërkesë subjekti zgjedhor Partia Socialiste, me përfaqësues zotin Eridjan Salianji për të marrë pjesë në këtë procedurë administrative.

Z. K. Bele: Në rregull, faleminderit! KAS i konsultuar në vend, vendos pranimin e subjektit. Atëherë të pranishëm, Sekretari i Përgjithshëm, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me kërkesë paraprake lidhur me përjashtimin e anëtarëve apo kërkesa të tjera procedurale kemi? Nuk kemi? Faleminderit! Atëherë vazhdojmë me shqyrtimin e themelit të çështjes. Dy fjalë Sekretari i Përgjithshëm.

Z. Y. Merhaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.340, datë 04.05.2021 ka miratuar tabelën përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore, Qarku Durrës, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021. Duke mos qenë dakord me këtë vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, dy subjektet zgjedhore kanë bërë ankim. Përkatësisht Partia Demokratike me kërkesë ankimore nr.37, datë 09.05.2021 si dhe subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, me kërkesën ankimore nr.46, datë 09.05.2021. Kërkesa i është drejtuar KAS-it. Jemi në seancën e KAS-it, për më tepër besoj, do të shpjegojnë ankuesit.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. K. Bele: Përfaqësuesi i subjektit ankues? Do ju lutesha në mënyrë koncize për parashtrimet lidhur me rastin që kemi sot.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit i nderuar! Lidhur me Qarkun Durrës, Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim ka kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25 prill 2021, në zonën zgjedhore Qarku Durrës dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve, për Kuvendin e Shqipërisë, në gjithë zonën zgjedhore Qarku Durrës, duke arsyetuar me një material prej rreth 57 faqesh. Të gjitha ato që ne kemi konsideruar shkelje të rënda të ligjit, të cilat në vlerësimin tonë, çojnë në pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre. Në datën 25 prill 2021, u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në Qarkun e Durrësit, në zonën zgjedhore Durrës, marrin pjesë në zgjedhje 160 mijë e 274 votues ose 44.96%. Në datën 26 dhe 27 prill u krye numërimi i votave për subjektet zgjedhore, gjatë së cilit u konstatua, 153 mijë e 47 fletë të vlefshme dhe 7808 fletë të pavlefshme. Mandatet në këtë zonë zgjedhore u ndanë si vijon: Partia Socialiste 8 mandate, Partia Demokratike 6 mandate, ndërsa diferenca ndërmjet votave të subjektit zgjedhor Partia Socialiste për mandatin e fundit në subjektin zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim, ishte 136 vota ose rreth 7 mijë e 672 më pak vota se numri i votave të pavlefshme. Lidhur me ato që ne i kemi konsideruar si shkelje të rënda të ligjit, të cilat cenojnë procesin zgjedhor në atë masë sa duhet konkluduar me pavlefshmërinë e zgjedhjeve, janë po ashtu të strukturuar ashtu si në rastet e mëparshme, në 5 kategori të caktuara. Së pari blerja e votës nëpërmjet përdorimit të personave me rekorde të tmerrshme kriminale, për të cilën ne kemi depozituar rreth 15 prova që Partia Demokratike ka pasur në dispozicion. Partia Socialiste kishte për drejtues politik në Qarkun e Durrësit, zotin Ardian Çela, drejtorin e Përgjithshëm të OSHE-së, një kompani me pronësi 100% shtetërore.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Zoti Çela është një person i vendosur zyrtarisht nën akuzë nga Prokuroria e Durrësit, në datën 30 qershor 2013 për favorizime dhe shkelje të tjera ligjore, në kohën kur ushtronte detyrën e nënkryetarit të Bashkisë Durrës dhe kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Megjithatë drejtuesi faktik i fushatës së Partisë Socialiste në Durrës, ishte ish-kryetari i Bashkisë, Vangjush Dako, i njohur për rekorde të tmerrshme korrupsioni dhe lidhje me krimin e organizuar. Ndërsa lidhjet me botën e krimit të organizuar të Vangjush Dakos, i cili vazhdon të jetë anëtar i kryesisë së Partisë Socialiste, janë shfaqur në fakt në mënyrë flagrante në të paktën 2 raste. Në 5 dhjetor 2016, Gjykata e Apelit Durrës vendosi lirim të Lulzim Berishës, një kriminel *recitivist*, drejtues i bandës së Durrësit, pasi kryetari i Bashkisë i asaj kohe, zoti Vangjush Dako kishte dhënë garanci për punësimin e tij në Bashki. Rast tjetër kishte të bënte me përfshirjen e Vangjush Dakos në dosjen penale 339/1 ku nga përgjimet e publikuara nga gazetatat gjermane “Bild”, rezulton se Vangjush Dako ka komunikim të vazhdueshëm me Astrit Avdylajn, drejtues i klanit të Avdylajve, një organizatë ndërkombëtare e trafikut të drogës dhe të gjitha këto komunikime zhvilloheshin në kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare, të vitit 2017. Në Qarkun e Durrësit, ku drejtues politik të fushatës ishin Ardian Çela dhe Vangjush Dako, të përfshirë në raste madhore të korrupsionit dhe krimit të organizuar, kandidat për deputet si dhe me detyrë ishin: Jurgis Çyrbja, Ilir Ndraxhi dhe Rrahman Rraja, të njohur për lidhjet e tyre me krimin e organizuar. Këta shtetas, pra zoti Jurgis Çyrbja, ish-drejtor i Kadastrës së Durrësit, ka dalë në mënyrë të përsëritur në përgjimet e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, si i përfshirë në veprimtari kriminale, dhe rasti konkret ishte privatizimi i ish-hotel “Vollga”. Ilir Ndraxhi, deputet i Partisë Socialiste dhe kandidat po ashtu në këto zgjedhje, doli në përgjimet e publikuara nga gazetatat “Bild”, të bandës kriminale Avdylaj, si njeri për të cilin kriminelët në fjalë, kishin punuar për të siguruar votat e tij. Së fundmi

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Rrahman Rraja së bashku me familjarët e tij njihet si një bandë kriminale në zonën e Fushë-Krujës, me lidhje të shumëfishta me krimin e organizuar brenda dhe jashtë vendit. Familjarët e tij në vijimësi janë pjesë e personave me rekorde të tmerrshme kriminale. Të nderuar anëtarë të KAS-it! Ashtu siç kemi parashtruar dhe më herët gjatë periudhës mars/prill 2021 Partia Demokratike ka depozituar 50 kallëzime penale në SPAK dhe 130 kallëzime në prokurinë e rretheve. Ndër 50 kallëzime të depozituara në SPAK, 30 prej tyre kanë të bëjnë me rastet flagrante të shit-blerjes së votës, nga drejtues, përfaqësues apo mbështetës të Partisë Socialiste, Në Qarkun e Durrësit për rastet e shit-blerjes së votës dhe shkeljet flagrante të ligjit që kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor, Partia Demokratike ka depozituar 2 kallëzime penale në SPAK, gjatë fushatës zgjedhore në datat 2 prill 2021 dhe 16 prill 2021 përkatësisht: Në datën 2 prill 2021 Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shtetasit: Jurgis Çyrbja-deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe kandidat për deputet në listën emërore të Qarkut të Durrësit, shtetasin Lefter Koka, deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe kandidat për deputet në listën shumëemërore të Qarkut Durrës, shtetasin Rrahman Rraja-deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe kandidat për deputet në listën shumëemërore të Qarkut Durrës, shtetasin Artur Bushi-kryetar i Bashkisë Krujë, shtetasin Ardian Çela-administrator i OSHE sh.a., shtetasin Plator Mehmeti-drejtor i Shoqërisë OSHE sh.a. në Durrës dhe shtetasin Durim Keqi, Altin Hajri, Artur Fetaj, Xhelal Rraja, Bert Hoxha, Fetah Mataj, Rroni Shota, Arbër Koka, Gentian Thartori dhe Emiljano Lako, si të përfshirë në një skemë kriminale të shit-blerjes së votës në Qarkun e Durrësit, përkatësisht në zonat Durrës, Fushë-Krujë, Shijak, Sukth, etj, Në datën 16 prill 2021 Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shtetasit: Ardian Çela-administrator i OSHE sh.a. dhe drejtues politik i PS-së për Qarkun Durrës,

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

shtetasin Roni Shopa-drejtues i AKU Durrës, Alfred Mullaraj-kryetar i Këshillit të Qarkut Durrës, Ledjon Lako-drejtor i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Ardian Çela-zv.drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Spartak Kovaçi-drejtor i UKD sh.a., shtetasin Ardjan Iljazi-drejtor shërbimesh në Bashkinë Durrës, Arben Isaku-drejtor juridik në Bashkinë Durrës, Emiljan Jani-drejtor i Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria Rajonale Durrës, shtetasin Ermal Pronjari-jurist në Drejtorinë Juridike të Bashkisë Durrës, përgjegjës për zyrën e rindërtimit, Joliand Mustafaraj-drejtor i Rezidencave Qeveritare, Durrës, Eljon Jani-jurist pranë Autoritetit Portual Durrës, Gerald Ceka-kancelar i Universitetit të Durrësit, Petrit Ismailati-drejtor i Shërbimit Social Shtetëror, Agim Karaj-drejtor i Formimit Profesional Durrës, Sorent Dedja Njala-nëpunës i Bashkisë Durrës, Denis Shkodra-punonjës i OSHE-së, Elvis Pingili-përgjegjës i ASHK-së, Dorian Baba-drejtor i OSHE-së Sukth, Indrit Cërrloi-drejtor i ISSH në Durrës, Ruzhdi Martini-punonjës i OSHE-së, Albert Bugaçja-administratori i Njesisë Administrative Rrashbull, Mariglen Mullai, Fetah Mata, Redon Qerreti, Ilir Lleshi, Edlir Topçiu, Oliver Xhamuçaj, Bledar Metalla, Edlir Topçiu, Gëzim Prenga, Gerald Dauti, Agron Haxhia, Zakarel Zake, Redian Kalastra, Jorgen Zaza, Kastriot Xhangolli, Ermal Kapllani, Fred Duli, Denis Gjoni, Sulejman Ibrahim, Mand Serri, Ed Serri dhe Xhemo Sula, të gjithë këta persona të skeduar dhe me rekorde kriminale, si të përfshirë në veprimtarinë kriminale të shit-blerjes së votës, në Qarkun e Durrësit. Faktet dhe grup-faktet e evidentuara të blerjes së votës në Qarkun Durrës nga eksponentë të Partisë Socialiste në bashkëpunim me persona me rekorde të tmerrshme kriminale në shërbim të PS-së janë evidentuar dhe faktuar nga ana e PD-së gjatë fushatës zgjedhore si më poshtë: Në Fushë-Krujë, Thumanë dhe Krujë për blerjen e votave dhe kërcënimin e votuesve gjatë zgjedhjeve ishte aktivizuar banda kriminale e fisit Rraja, me në krye Xhelal Rrajën,

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

person me disa rekorde të tmerrshme kriminale, vëllai i kandidatit për deputet të Partisë Socialiste, Rrahman Rraja. Po ashtu në këtë zonë, dhe kryesisht në zonën e Thumanës ishte aktiv në blerje votash dhe presione mbi qytetarët, kryetari i Bashkisë Krujë, Artur Bushi, po ashtu një person me rekorde të tmerrshme kriminale. Në Qarkun e Durrësit në krye të skemës së blerjes së votave ka qenë vetë drejtuesi politik i PS-së për Durrësin, njëkohësisht dhe drejtori i OSHE-së Ardian Çela, i cili ka shpërndarë paratë tek individë që mbulojnë zona të veçanta. Gjithashtu një ndër personat më aktivë për blerje votash ishte dhe Plator Mehmeti-drejtor rajonal i OSHE Durrës. Artor Fetaj është një tjetër person, i cili nuk është banor i zonës Shkallnur, ish-Komuna Rrashbull, por njihej si i dërguari i Ardian Çelës në këtë zonë, ky shtetas me precedentë penalë, i dënuar së bashku me shtetasin tjetër Aljon Hyska-drejtor i Ndërmarrjes së Rrugëve Durrës, kanë qenë personat përgjegjës për blerjen e votave, në zonën e Shkallnurit, ish- Komuna Rrashbull, Njësia Administrative Rrashbull. Në Shijak ishte angazhuar totalisht në blerjen e votave Altin Hajri, aktualisht i shpallur në kërkim për pengmarrje dhe vrasjen e shtetasit Jani Prenga tek resorti i tij “Gold”, në Pjesëz, Shijak. Të qenurit në kërkim nuk e ka penguar këtë shtetas të lëvizë lirisht dhe të blejë vota për Partinë Socialiste, ai shoqërohej rregullisht me Ardian Çelën dhe pothuajse çdo natë me deputetin e Partisë Socialiste Jyrgis Çyrbja. Aksioni i OFL-së filloi një vit më parë pikërisht me sekuestrimin e këtij resorti, pra të shtetasit Altin Hajri, duke e klasifikuar si produkt të veprimtarisë kriminale dhe vetë pronarët e tij si persona me rekorde të tmerrshme kriminale. Kontrata e drejtuesit politik zyrtar, Ardian Çelës dhe drejtuesit faktik Vangjush Dako, me pronarët e resortit “Gold”, ishte e qartë: “Hajri na ndihmon në zgjedhje të fitojmë, ne i çlirojmë pronën nga sekuestrimet e SPAK-ut”. Në zonën e Spitallës në Durrës ishte angazhuar në krye të skemës për blerje votash Arbër Koka, djali i deputetit të Partisë Socialiste Lefter

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Koka. Në lidhje me të funksionojnë si koordinatorë të Partisë Socialiste edhe shtetasit: Gentian Thartori, Roni Shopa, Fetah Mataj dhe Emiljano Lako, persona të skeduar me rekorde të tmerrshme kriminale në këtë qark. Në Shijak ishte aktiv në blerjen e votave për Partinë Socialiste Durim Keqi. Ky shtetas është dënuar nga Gjykata e Gjenovës në Itali me 9 vjet e 7 muaj burg për veprat penale, pjesëmarrje në organizatat kriminale me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike, shfrytëzim prostitucioni apo trafikim të lëndëve narkotike si dhe vepra të tjera. Në fshatin Kameras, në Manzë, shtetasi dhe kryeplaku i fshatit Lul Dema mbante fletore me emra dhe mbiemra të personave me vota që do të sillnin dhe vlerën e parave, të dhëna në favor të Partisë Socialiste, çka provon qartazi për një skemë flagrante dhe të mirëstrukturuar të blerjes së votës. Të gjitha sa më sipër, të provuara dhe faktuara gjenden në provat e bashkëlidhura që Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim ka depozituar si pjesë e kërkesës ankimore të paraqitur përpara këtij institucioni. Faktet dhe grup-faktet e paraqitura provojnë katërcipërisht shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor me qëllimin e qartë për të ndikuar mbi rezultatin zgjedhor dhe ndarjen e mandateve. Partia Demokratike ka denoncuar në mënyrë të vazhdueshme faktin se në zonën zgjedhore, Qarku Durrës, nuk kishte përballë një parti politike dhe kandidatët e saj që garonin me ofertat e tyre politike, por kishte grupe, struktura kriminale dhe bandat që blinin votat, kërcënonin qytetarë, intimidonin nëpunësit publikë, shpërndanin leje legalizimi, ndërtimi, licenca, shpërblime dhe prokurime publike. Të nderuar anëtarë të KAS-it! Shumë nga shtetasit që sapo u përmendën, të cilët janë të njohur dhe të skeduar qoftë në Shqipëri, ashtu dhe në vende të tjera të Evropës, apo në vende të ndryshme. Shumëkush nuk do kishte as guximin t’jua përmendte emrat në Qarkun e Durrësit apo në vendet e tjera, për shkak të lidhjeve të tmerrshme kriminale që këta persona kanë. Ata u angazhuan tërësisht, përgjatë gjithë fushatës zgjedhore,

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021**

thjesht dhe vetëm për të ruajtur pushtetin e Partisë Socialiste, me qëllim që më pas t'iu garantoheshin favore të ndryshme gjatë qeverisjes së kësaj partie. Në datën 24 prill, pak orë përpara fillimit të votimit, në një konferencë për shtyp, kryetarja e LSI-së, zonja Monika Kryemadhi tregoi një *database* të Partisë Socialiste për Durrësin, të ngjashme dhe me atë për Tiranën, ku pranë emrave të zgjedhësve ishin dhe emrat e patronazhistëve të tyre dhe shumat e parave që u kishin dhënë në këmbim të votës, çka faktoi se gjithë personat e përmendur më sipër, të angazhuar si koordinatorë, patronazhistë, ishin blerës votash të drejtuar nga Ardian Çela dhe Afrim Baka. Lista e publikuar kishte minimalisht 300 emra, çka është disa herë më shumë se sa diferenca që ekziston ndërmjet partive politike për mandatin e deputetit në Qarkun e Durrësit. Por blerja e votës, të nderuar anëtarë të KAS-it nuk u bë thjesht dhe vetëm nëpërmjet parave, kërcënimeve, shantazheve dhe presioneve, por edhe nëpërmjet dhënies së *bonus*-eve dhe përfitimeve të tjera, të cilat ishin në dispozicion vetëm të organeve të administratës publike. Sipas të dhënave të publikuara në media, nga organizata të shoqërisë civile, bashkitë e prekura nga tërmeti dhe veçanërisht Bashkia Durrës shpërndau në periudhën janar/prill 2021 rreth 125 milionë euro në total në gjithë Shqipërinë dhe vetëm Bashkia Durrës shpërndau 6 milionë euro për procesin e rindërtimit ose 89 herë më shumë se sa kishte shpërndarë në 15 muajt e fundit. Nërkohë në një denoncim të bërë publik në media drejtuesi politik i Qarkut Durrës, Ardian Çela, u ka paguar 13 mijë punonjësve të OSHE-së një rrogë plus gjatë fushatës elektorale të Partisë Socialiste me qëllimin e vetëm marrjen e mbështetjes për këtë parti. Po ashtu, të nderuar siç kemi pasur mundësi të relatojmë edhe më herët Këshilli i Ministrave vazhdoi që në kundërshtim me nenin 91 dhe vendimin nr.9/2020, të Komisionit Rregullator të KQZ-së të prodhojë akte ligjore dhe nënligjore, të cilat synonin të sillnin përfitime për kategori të caktuara shoqërore. Të gjitha këto dëshmojnë se

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

pushteti dhe Partia Socialiste ishin të angazhuar në manipulimin e vullnetit të zgjedhësve, jo vetëm nëpërmjet blerjes së votave me dhënie të hollash, por edhe përfitimesh dhe të mirash të tjera materiale drejtpërdrejt nga fondet dhe buxheti i shtetit. Pika e dytë, të nderuar, ka të bëjë, shtylla e dytë në fakt, ka të bëjë me vendosjen e shtetit në shërbim të partisë duke përdorur në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore për devijimin e vullnetit të zgjedhësve. Tenderat dhe prokurimet publike u përdorën për t'ua dhënë personave me rekorde kriminale në këmbim të mbështetjes politike në zgjedhje. Viti 2020, si një vit parazgjedhor pa një rritje shumë të lartë të kontratave publike, qoftë në numër ashtu edhe në vlerën e tyre, 878 kontrata publike, me vlerë 505 mijë milionë euro u prokuruan në vitin 2020, ndërkohë që mesatarja e vlerës së kontratave publike të 5 viteve të fundit është me vlerën 116 milionë euro. Pra kontrata publike të prokuruar në vitin 2020 ishin rreth 5-fishi i atyre që janë prokuruar në 5 vitet e fundit. Shteti u vu në dispozicion të Partisë Socialiste për të marrë përkrahjen e personave me rekorde të tmerrshme kriminale që kanë mbështetur Partinë Socialiste me financime përgjatë fushatës në këmbim të përfitimeve të fondeve publike, konkretisht shtetasi Anton Gjinaj, është person me rekorde të rënda kriminale, i arrestuar dhe dënuar për trafik droge, në Itali dhe Spanjë. Ky shtetas është një nga mbështetësit kryesorë të Partisë Socialiste, i cili u shpërblye me 13 procedura prokurimi me vlerë rreth 9 milionë euro nga Bashkia Durrës, që më pas kjo mbështetje dhe gjithë këto fonde të përktheheshin në blerje vote gjatë fushatës zgjedhore.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: I cili u shpërblye me 13 procedura prokurimi me vlerë rreth 9 milion euro nga Bashkia Durrës që më pas kjo mbështetje dhe gjithë këto funde të përktheheshin në blerje vote gjatë fushatës zgjedhore. Në datën 15 Mars 2021, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, ka publikuar në faqen e saj zyrtare njoftimin e kontraktës së konçesionit me objekt, Ndërtimin Zhvillimi Mirmbajtja dhe Operimi i zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës me kohë zgjatje 99 vjet. Po, ashtu Këshilli i Ministrave publikoi Konçesionin mbi përcaktimin e metodologjisë dhe procedurave për përdorimin e trafikut në fushën e hidrokarbureve. Të dyja këto procedura konçesionesh dhe prokurimesh të shpallura në periudhës 4 muaj përpara zgjedhjeve janë në kundërshtim të qartë me vendimin nr.9 2020 të Komisionit Rregullator që ndalon shpalljen e kontratave publike të piprive dhe konçesioneve në këtë periudhë. Shteti po ashtu vendosi të gjitha investimet publike dhe të gjitha fondet e rindërtimit në funksion të Partisë Socialiste për zgjedhjet. Kryeministri Rama, Ministrat, Deputetët dhe Kryebashkiakët e Partisë Socialiste, përdorën investimet publike për propagandë politike në kundërshtim me parshikimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra nga KQZ. Në 20 raste për të cilat Partia Demokratike ka depozituar pamjet filmike, foto dhe video ndër të cilat shfaqen edhe shtetasit kandidat për deputet dhe deputet aktual Milva Ekonomi, Roland Xhelila dhe Rrahman Rraja, promovuan investimet publike me qëllime të pastra elektorale. Në 100 raste të tjera për të cilat Partia Demokratike ka depozituar provat përkatëse, deputet të Qarkut Durrës përdorën ndihmën e dhënë nga shtetit për procesin e rindërtimit për të bërë fushatë elektorale. Konkretisht shtetasit Edi Rama me detyrë Kryeministër i Shqipërisë dhe Kryetar i Partisë Socialiste, shtetasi Milva Ekonomi me detyrë Ministre e Bujqësisë, shtetsasi Ilir Ndraqi, Roland Xhelilaj apo dhe Rrahman Rraja. Të gjithë këta shtetas në fakt shpërndanë çelsa të shtëpive të rindërtuara apo u shfaqën në pamje filmike gjatë promovimit të fondeve që kishte

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

dhënë shteti apo Bashkia Durrës, për procesin e rindërtimit. Më tej të nderuar, gjatë fushatës të Partisë Socialiste u përdor masivisht intimidimi i Administratës Shtetërore për të mbështetur këtë parti me qëllimin e vetëm favorizimin e saj gjatë zgjedhjeve. Gjatë fushatës u konstatuan raste të shumta të cilat janë denoncuar vazhdimisht se si të gjitha nivelet e Administratës Qendrore dhe Vendore ishin përfshirë në fushatë duke mbështetur publikisht kandidatët të Partisë Socialiste. Drejtoritë Vendore Arsimore, Drejtoritë Vendore të Bujqësisë, spitalet rajonale, shkollat e mesme Agjensitë Vendore të Kadastrës Administratat e Policisë dhe Burgjeve u kthyen gjatë fushatës zgjedhore në shtabë elektorale të Partisë Socialiste. Ne kemi denoncuar së paku dy raste të cilat janë flagrante që dëshmojnë për përdorimin masiv që ju bë në mënyrë të paligjshme Administratës Publike. Me datën 8 Prill 2021, në media u publikua një mesazh që Drejtori i Drejtorisë Juridike në Qarkun Durrës, në Bashkinë Durrës zoti Arben Isaku, më herët ish Drejtor i Aluizmit i arrestuar për shpërdorim detyre u shkruante varësve të tij. Teksti i këtij mesazhi ishte si më poshtë. Përshëndetje duke filluar nga sot e në vazhdim asnjë punonjës shteti nuk ka pse shkon në punë, të evidentohen njerëzit green dhe pa info që keni në QV deri të Djelën në darkë duhet të jenë përfunduar listat dhe deri në 12 të natës të rrinë po të jetë nevoja. Mbas 16 ditëve kemi zgjedhjen, krehja e njerëzve gri mos bëni kot për të mbaruar punën dhe kaq, po me serjozitet sepse të palarat dalin shumë kollaj nga qendra. Ky mesazh i dërguar në rrjetin e komunikimit Whatsapp dëshmon qartë për përdorimin masiv të administratës për fushatë duke deklarua se asnjë punonjës shteti ska pse shkon në punë. Më tej ai kërcënonte punonjësit se nëse nuk e bëjnë punën ashtu siç duhet ajo do të zbulohet dhe ndaj tyre do të merren masa. Po ashtu, në datën 20 prill 2021, u denoncua rasti se si drejtuesit politik të Partisë Socialiste për këtë qark Ardian Çela i cil së bashku me personat e denoncuar merrej për krime

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

zgjedhore në praninë e Drejtorit Vendor të Kadastrës së Durrësit Rezart Elmazi ka mbledhur shefat dhe punonjësit e kadastrës.

Z. K. Bele: Mbani pak qetësi!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kanë vjedhur shefat por dhe punonjësit e Agjensisë së Kadastrës duke kërkuar që pa asnjë lloj kompromisi të punojnë, legalizojnë dhe çertifikojnë çdo lloj shërbimi që kërkohet nga shtabet elektorale të Partisë Socialiste. Gjatë kësaj periudhe qytetarët e vetëm që do të marrin shërbim do të jenë ata të referuar nga selia e Partisë Socialiste në qytet në të kundërt ata kërcënoheshin se këta punonjës do të largoheshin nga puna. Po ashtu të nderuar anëtar të KAS ne e kemi shjeguuar edhe në procese të më hershme se si Administrata Publike në 4 muaj u rrit me rreth 13 mijë punonjës, duke bërë që të paguheshin rreth 60 milion euro paga më shumë se e vitit të mëparshëm. Nga ana tjetër dhënia e lejeve të legalizimit dhe ndërtimit ishte një fenomen masiv në Qarkun e Durrësit, konkretisht deputet të ndryshëm të Partisë Socialiste shpërndanë leje legalizimi në aktivitete publike në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr.9 2020 të Komisionit Rregullator të KQZ. Në 9 raste së paku Partia Demokratike ka depozituar foto dhe video ku kandidatët për deputet shpërndajnë Leje Legalizimi në periudhën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor me qëlime të pastra elektorale. Në 18 Prill drejtuesi politik i Partisë Demokratike për Qarkun Durrës Edi Paloka ka paraqitur provat se si Ergys Qyrbja kandidat për deputet i Partisë Socialiste dhe ish drejtor i Agjensisë së Kadastrës në këtë qytet së bashku me drejtues të institucioneve lokale dhe antarë të Partisë Socialiste në Durrës kanë shpërndarë Leje Legalizimi dhe certifikata pronësie sikur Qyrbja të vazhdonte të ishte akoma Drejtor i Kadastrës me qëllim të qartë dhënien e legalizimeve dhe certifikatave në këmbim të votës. Këto

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

raste janë kallzuar penalisht edhe në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nga përfaqësuesit e Partisë Demokratike. Besoj se të gjithë e kujtojmë edhe përgjimin e Artan Lames lidhur me 160 mijë kërkesa për Lejen e Legalizimit të cilat do të trajtoheshin në mënyrë preferenciale në mënyrë për tu kthyer në mbështetje masive për Partinë Socialiste. Po ashtu, ndoshta dhe ndoshta për të mos kaluar në përsëritje ne e kemi relatuar në mënyrë të përsëritur përpara këtij komisioni se si të dhënat personale të qytetarëve u vodhën nga Partia Socialiste dhe u përdorën në mënyrë të paligjshme në servat e saj për gjatë fushatës elektorale. Por ajo që ndoshta vlen për tu ndalur në këtë pikë është ende denoncimi i sipër cituar i bërë nga Kryetaria e Lëvizjes Socialiste për Integrim sa i përket ekzistencës nga data base e të dhënave personale të ngjashme nga ato që ekzistonte në Tiranë por edhe në Durrës. Ku ekzistonin të dhënat personale ku më shumë se 350 mijë zgjedhës me emër, mbiemër nr. ID, nr. telefoni vendbanimi shuma që do të paguhet për blerjen e votës, madje edhe mënyra e raportimit nëpërmjet fotografimit apo trenit bullgar, termi përdoret për të përshkruar plotësimin e fletëve të votimit jashtë qendrës së votimit. Po ashtu të nderuar ne kemi relatuar në mënyrë të përsëritur se si vendimi i Komitetit Teknik të Ekspertëve i marrë vetëm një javë përpara zgjedhjeve ishte një vendim që efektivisht i mohoj të drejtën për të votuar rreth 500 mijë shtetasve shqipëtar që jetojnë në Greqi apo në Maqedoninë e Veriut me të drejtë vote. Sigurisht që në Qarkun e Durrësit ku diferenca për mandatin e parë ndërmjet Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe Partisë Socialiste mohimi i të drejtës së 500 mijë shtetasve shqipëtar. Jemi të bindur që do të kishte bërë diferencën dhe do kishte ndikuar drejt në rezultatin e zgjedhjeve në këtë qark. Po ashtu ndoshta për tu ndalur shkurtimisht pasi kemi pasur mundësinë ta trajtojmë gjerësisht është edhe fakti që numëri i fletëve të votimit të pa vlefshme të cilat edhe në Qarkun e Durrësit ishin rreth 5% e totalit të votuesve patën një ndikim të drejtpërdrejt në rezultatin

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

përfundimtar të zgjedhjeve. Nga ana tjetër të nderuar edhe në Qarkun e Durrësit ashtu si në qarqet e tjera ne kemi dyshimet dhe informacionet tona të cilat kemi pasur mundësinë edhe ti bëjmë publike se edhe në këtë qark pati rastin të votimit të shumëfishtë, votimit familjar apo votimit për të tretët. Për të cilat ne kemi kërkuar nga ana e këtij komisioni që siç ka berë edhe në rastet e mëparshme të na administronte edhe në paisjet e identifikimit elektronik. Në përmbledhje të të gjitha fakteve të sa më sipërme dhe të relatuar për të cilat Partia Demokratike ka vënë në dispozicion rreth 40 prova që ka pasur në dispozicion. Vlen të konkludohet se në Qarkun Durrës Partia Socialiste nuk përdori kandidatët e saj apo dretuesit e saj për të mbledhur vota për subjektin politik Partia Socialste. Në këtë qark pati një strukturë të mirfilltë kriminale. E cila u shtri në çdo zonë në çdo fshat në çdo lagje për të blerë vota ku ishin të përfshirë persona me rekorde të tmerrshme kriminale. Persona të cilët në zonën e tyre qoftë edhe përmendja e emrit të tyre shkakton frikë te qytetarët. Nga ana tjetër Qarku Durrës është shembulli më flagrant si i gjithë shteti u vu në dispozicion të partisë dhe se si shteti dhe Partia Socialiste u shkri në një të vetme. Të gjitha këto shkelje të nderuar anëtar të KAS kanë bërë që 25 Prilli në Qarkun e Durrësit të mos ishte një ditë zgjedhjesh të lira të ndershme dhe të barabarta, por të ishte një ditë ku krimi dhe paligjshmëria diktuan vullnetin e zgjedhësve faleminderit.

Z. K. Bele: Po, faleminderit përfaqësuesi i subjektit LSI. Të keni parasysh që për procedurën do ecim mbi pavlefshmëritë dhe pastaj me kërkesë tuaj.

Fillojmë me procedurën me Qarkun e Beratit.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Fillojmë me procedurën me Qarkun e Beratit. Faleminderit për fjalën zoti Bele. Të nderuar anëtar të KAS jemi drejtuar këtij komisioni me datën 09.05.2021 me një kërkesë ankimore për objekt të së cilës

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

kërkojmë ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që mban numërin 240 datë 04.05. 2021. Lidhur me këtë kërkesë kërkojmë në komision që të shqyrtohet kërkesa jonë po ashtu lidhur dhe me pikën 2 të saj, që parashikon rinumërim dhe rivlerësim të votave për të gjitha ZAZ e Qarkut Durrës dhe miratimin e tabelës përmbledhëse në zonën zgjedhore Qarku Durrës duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votës. Filimisht do të doja të kisha pak suportin e administratës për të depozitar pranë këtij komisioni disa fletë votimi të cilat janë gjetur jo në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 117 të Kodit Zgjedhor, në cilësinë e provës materiale këto fletë janë dukshëm të pa vlefshme dhe janë konsideruar si të vlefshme. Në qoftë se do të më lejoni zoti relator dikush nga administrate...

Z. K. Bele: Po patjetër mund t'i marrë përfaqësuesi, po zoti Kaziaj do të shpreheshim për pavlefshmëri dhe do vazhdojmë..

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Përsa i përket pjesës të relatimit që ka bërë kolegu Logu i kërkesës për pavlefshmëri në zgjedhje në Qarkun e Durrësit ne ndajmë të gjitha shqetësimet me Pratinë Demokratike e mbështesim këtë kërkesë pavarësisht se domethënë qëllimi ynë nëpërmjet kqyrjes të pamjeve filmike që kemi marrë nga KQZ, ka qenë ai i një rivlerësimi të votës duke parë që vullneti i qytetarëve është tjetërsuar dhe nuk është bërë në përputhje me nenin 117 të Kodit Zgjedhor. Kam mbështetje të plotë të kërkesa e Partisë Demokratike dhe të relatimit që bëri kolegu Logu lidhur me të themi shqetësime të provuara më vonë të kthyer në prova për ata persona dhe për gjithë makinerinë shtetërore të vënë në dispozicion e votës në këtë qark. Kështu jemi dakord me kërkesën e Partisë Demokratike lidhur me

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe momentin e dytë kur të kemi pjesën e relatimi për objektin të kërkesës tonë.

Z. K. Bele: Dakord, faleminderit përfaqësuesi i palës së interesuar.

Z. E. Salianji, Përfaqësues i PS-së: Faleminderit, për sa i përket kërkesës ankimore të relatuar, kjo kërkesë nga ana formale ligjore procedurave nuk mbështete në dispozitat e Kodit Zgjedhor, në asnjë prej neneve të tij. Neni 160 i ka të sqaruara qartë rastet e pavlefshmërisë, ku pavlefshmëria lidhet me shkeljet e ndodhura në qendrën e votimit, ditën e zgjedhjeve. Në asnjë prej asaj çka dëgjuam nuk u përmend asnjë qendër votimi, asnjë shkelja lidhur me procesin e votimit. Për sa i përket thelbit ne e kemi mbajtur qëndrimin tonë. Keto janë opinionet e Partisë Demokratike që për ne janë në kufijtë e shpifjes por, nuk i hymë dhe as nuk i diskutojmë. Unë besoj që ju duhet ta rrëzoni kërkesën si të pa mbështetur në Kodin Zgjedhor. Ato çka lexohen këtu nuk kanë lidhje fare më procesin zgjedhor të zhvilluar me datë 25 Prill, faleminderit.

Z. K. Bele: Ju faleminderit zoti Salianji! Anëtarët kanë ndonjë pyetje në këtë fazë të procesit? Mirë, nëse skemi pyetje vazhdojmë me paraqitjen e provave të kërkuara nga palët! Fillimisht pala ankuese. Po provat e kërkuara dhe provat e depozituara, me fal nëse e vlerësoni për ekonomi të procesit duke qenë se kemi dhe 7 ankime në rresht do ta vlerësonim nëse mundet që këto prova të dispononi duke na cituar.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po, lidhur me provat që ne kemi paraqitur dhe depozituar i keni të cituara në faqen 56 57 dhe 58 në qoftë se komisioni nuk e vlerëson të nevojshme që ne të citojmë çdo njëjërë prej tyre sepse janë rreth 42 prova

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

dhe do i binte që mund të merrte një kohë të konsiderueshme. Mund ta konsiderojmë të ezaurueshme këtë fazë nga fakti që janë të cituara në kërkesën tonë ankimore.

Z. K. Bele: Po faleminderit, ato janë të cituara dhe të administruara fizikisht në dosjen përkatëse dhe në këtë fazë provat i ka sjell, ne sipas një praktike tashmë të konsoliduar, KAS i konsultuar në vend vendos për nenin e këtyre provave dhe bërjen pjesë të fashikullit të këtij shqyrtimi administrativ. Palët e tjera kanë prova pra për këtë kërkesë? Për kërkesën për pavlefshmërinë?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: I nderuar zoti kryetar, për sa i përket pjesës së kërkesave tonë lidhur me provat, ne kërkojmë që të merrët një provë kryesisht që është ajo që ka qenë dhe vijuese në proceset e mëparshme të themi të kërkesave ankimore që është evidenca e PEI për kryqëzimin e të dhënave për të parë se çfarë ka ndodhur në këtë qark.

Z. K. Bele: Dakord, për procedurë do të vazhdojmë tek kërkesa për marrjen e provave të tjera përveç atyre të depozituara. Përfaqësue si i subjektit ka ndonjë Salianji?

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Për sa i përket kërkesës së provave të paraqitura nga Partia Demokratike besoj ato nuk do merren për arsye se nuk janë prova donacion zgjedhor ndërsa për sa i përket PEI unë besoj e lë në çmimin tuaj si kolegj për të vendosur.

Z. K. Bele: Mirë, faleminderit.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: I nderuar për procedurën provat tona u administruan apo jo?

Z. K. Bele: Po, po në fakt duhet të ishin degjuar nga kolegët por për procedurë vazhdojmë me administrimin e provave sipas citimit të bërë nga kërkuesi në faqet përkatëse të fashikullit ku jemi administruar.

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Një sqarim për procedurë pra u paraqitën te ju jo se janë bërë pjesë e shqyrtimit si prova?

Z. K. Bele: Zoti Salianji pala ankuese ka paraqitur prova shkresore të cilat përfaqësuesi pra i citoj. Duke qënë se këto janë të administruara janë kryesisht të natyrës shkresore ato që janë dhe në themel të ankimit. Zgjedhëm për ekonomi të procesit mos ti citonim, megjithatë në diskutimet tuaja përfundimtare nëse do keni gjëra që mendoni se duhet ti parashtroni për secilën prej tyre, mund ta bëni. Tani vazhdojmë me fazën tjetër me kërkesën për marrjen e provave?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po, edhe sa i përket provave që ne kërkojmë të merren në përputhje me nenin 136 dhe 137 të Kodit Zgjedhor të nderuar anëtar të KAS janë të cituara në faqet 50, 51 dhe 52. Janë kërkesa të cilat nga ana jonë janë bërë edhe më para për qarqe të tjera. Në qoftë se është e nevojshme ne nga ana jonë mund të citohen ose të vlerësohen nga ana juaj duke qënë se janë të cituara të mos bëhet përsërija e tyre të themi për ekonomi administrative.

Z. K. Bele: Faleminderit. Duke qënë se ju dhe gjatë shqyrtimit një pjesë të tyre ishin pjesë e asaj që parashtruat ne i kemi dhe të listuar dhe janë të njohura për palët të

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

cilat kanë pasur mundësinë të marrin kopje nga kjo pjesë e ankimit. Gjithsesi nëse doni të sqaroni diçka?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Jo, përveç atyre i nderuar ne besojmë domethënë të gjitha faktet rrethanat dhe gjithçka që ne parashtruam do faktojë në përmasat e saj reale dhe të marrjes së ketyre provave pranë organeve të Administratës Publike me nenin 137 si prova që duhet të administrohen nga administrata zgjedhore kërkojmë po ashtu siç kemi kërkuar dhe më përpara të merren të dhënat e kryqëzura ndërmjet paisjes të identifikimit elektronik PEI për zonën zgjedhore Qarku Durrës. Si dhe nga ana jonë janë depozituar 3 lista me rreth 300 emra të cilat janë pjesë e provave të administruara dhe kërkojmë që nga administrata zgjedhore të verifikohen në qoftë se këta persona kanë votuar në zonën zgjedhore Qarku Durrës. Në cilat qendra votimi kanë votuar, në cilat KZAZ etj? Si dhe në qoftë se këta persona kanë qenë pjesë e administratës zgjedhore.

Z. K. Bele: Më fal i kemi të listuara në qoftë se i kemi të cituara si numër, pra marrja e të dhënave nga PEI është prova juaj nr. 20?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kurse ajo që sapo ju relatova i nderuar është një provë e re që nuk është e cituar në kërkesën tonë ankimore por që po e bëjmë në mënyrë verbale.

Z. K. Bele: Dakord, mirë. por e keni depozituar shkresërisht apo e keni aty? Pra lista me 300.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Lista është pjesë e provave tona i nderuar. Pjesë e provave tona që kemi depozituar është edhe një listë me 300 emra personash.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: ... të cilët ne i mendojmë si persona të cilët kanë të dhëna personale: emër; mbiemër; nr. telefoni; qendër votimi; adresa por edhe shumat e parave që ata kanë marrë në këmbim të votës dhe duam që nëpërmjet të dhënave që do të kryqëzohen nga ana e administratës zgjedhore të verifikohet nëse këta persona kanë votuar, nëpërmjet listave të votuesve, si dhe të paraqiten të dhëna nëse këta persona kanë qenë pjesë e administratës zgjedhore. Janë prova që mund të merren nga ana e vetë KQZ-së, sepse janë në administrim të KQZ-së.

Z. K. Bele: Pra nga lista me 300, nëse e kuptova drejt, ju keni dy kërkesa, një nga të cilat është të verifikohet nëse këta kanë votuar, dhe kërkesa e dytë, të verifikohet statusi i tyre në raport me administratën zgjedhore.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: E drejtë i nderuar!

Z. K. Bele: Mirë faleminderit! Po zoti Braho!

Z. L. Braho: Atëherë zoti Logu! Ju keni një listë me 300 emra personash, apo jo?! Që ta kuptojmë qartë kërkesën! Kush është qëllimi i kërimit të kësaj prove? Pra, kush është qëllimi që doni të bëni kryqëzimin nëse këta 300 emra kanë votuar ose jo?, kjo së pari, dhe së dyti nëse pjesë të tyre kanë qenë në administratën zgjedhore në qarkun e Durrësit, apo jo?!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po, zoti Braho! Faleminderit për pyetjen! Nga informacioni që ne kemi marrë, kjo listë që ka emra, mbiemra, të dhëna personale dhe qendrat e votimit por edhe shuma parash që këta persona kanë marrë në këmbim të votave, provon një nga pretendimet tona kryesore, që ka të bëjë me faktin që blerja

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.05.2021*

e votës në qarkun e Durrësit ka diktuar rezultatin e këtyre zgjedhjeve, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një numër të konsiderueshëm qytetarësh, prej 300 personash, dhe kjo sigurisht në qarkun e Durrësit bëhet veçanërisht domethënëse, për shkak se diferenca ndërmjet partisë socialiste dhe partisë Lëvizja Socialiste për Integrim është vetëm 136 vota. Pra, e marrë kjo provë në vetvete dhe e provuar nëse ata kanë qenë pjesë e administratës zgjedhore, në një kohë kur disponohet një informacion i besueshëm, që ata janë paguar, dhe ka edhe persona, që po themi se ju kanë shpërndarë para, atëherë, kjo besoj se provon një nga pretendimet tona kryesore që ka të bëjë me blerjen e votës.

Z. L. Braho: E dispononi këtë listë, aktualisht?!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Lista, i nderuar, është pjesë e provave që partia Demokratike ka depozituar së bashku me kërkesën e saj ankimore.

Z. K. Bele: Unë në fakt po i kaloj provat e cituara nga faqja 56 deri në 58; ndoshta unë nuk po arrij ta identifikoj si duhet; ju lutem me ndihmoni për ta gjetur për efekt të shqyrtimit të veçantë të kësaj prove.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: I nderuar, është pjesë bashkëshoqëruese e provës nr. 15!

Z. K. Bele: Prova nr. 15. Foto dhe skema e ...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Pjesë e asaj, ... atij informacioni që është bërë publik në media etj., ka dhe një listë me 300 persona shoqëruar me emra mbiemra,

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.05.2021*

qendër votimi, dhe të dhëna të tjera si dhe shuma që ata kanë marrë nga 100 deri në 300 euro në këmbim të votës së tyre.

Z. K. Bele: Po!

Z. L. Braho: Atëherë, zoti Logu unë e kuptova pak a shumë, dhe që unë e kuptoj që është diçka që mund të bëhet dhe nga administrata do të kërkojmë listën e personave që kanë qenë të përfshirë në administratën zgjedhore në qarkun Durrës; juve mund tu jepet lista n.q.s. do të arrijmë tek ajo vendimmarrje dhe tek ajo kërkesë; dhe me pas kryqëzimi nëse këta persona kanë qenë, ... ose me saktë nëse këta 300 persona janë pjesë e administratës zgjedhore, këtë e bëni ju dhe e paraqisni në formën e pretendimeve. Ndërsa për pjesën nëse këta persona kanë votuar ose jo, këtë duhet të na e shpjegojë administrata zgjedhore, nëse është e mundur për ta identifikuar; sa kohë duhet?! etj., etj.!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Braho, një shpjegim të vogël nëse mundem?! E mira është se këta persona janë plotësisht të identifikueshëm. Pra, ka të dhëna të mjaftueshme që edhe po të verifikohet me listën e zgjedhësve, del konkretisht se ku e ka qendrën e votimit x apo y person! Dhe pastaj lista e zgjedhësve, që është ajo listë që është mbajtur në qendrën e votimit përkatës mund të kryqëzohet me këtë listë, për të parë nëse personi ka votuar apo jo! Besojmë që është një veprim që mund të marrë kohë; po supozojmë kështu; por që është një veprim plotësisht i mundshëm.

Z. L. Braho: Këtë e kuptoj unë që mund të bëhet. Mund të bëhet duke hapur materialet zgjedhore; por, unë nga administrata doja të dija nëse mund të bëhet pa hapur materialet zgjedhore, nëpërmjet sistemit PEI. Pra, besoj që tani janë kryqëzuar, ... nuk e di a janë të dhënat?! Pra, për këtë do të doja të sqarohesha nga

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.05.2021*

administrata zgjedhore; sepse me hapjen e materialeve e kuptoj që mund ta zbulojmë.

Z. Y. Merkaj: Pa hapur materialet zgjedhore nuk bëhet ajo! Nuk mund ta identifikojmë me pajisjen PEI. Nuk mund të bëhet pa hapur materialet zgjedhore, pa parë edhe listën e zgjedhësve. Edhe kjo prapë, nuk e dimë se si kanë votuar ose si është orientuar komisioni i qendrës së votimit, pasi orientimet e KQZ-së kanë qenë: aty ku punon pajisja PEI, nuk do të këtë nënshkrime tek lista e zgjedhësve. Kështu që edhe nëse ka punuar pajisja PEI dhe marrim listën e zgjedhësve, mund të mos jenë nënshkrimet e personave që kanë votuar.

Z. L. Braho: Ylli, këtë e kuptoj unë! Nuk është fjala që të kemi nënshkrimin fizik. Tani me sa kemi parë nga kryqëzimi i listës së të dhënave, aty janë të identifikuar të gjitha rastet e njerëzve që kanë votuar, pavarësisht se ne na vijnë me nr. personal të pjesshëm, për arsye që të mos bëhet identifikimi. Tani unë kam parasysh që në momentin që ajo listë është e plotë mund të dalin edhe emrat sepse numrat personal të këtyre 300 personave besoj se gjenden në listën e zgjedhësve, dhe KQZ-ja i ka, sepse i ka pasur gjithmonë. Dhe nga pajisjet PEI, nëse ka ndonjë qendër votimi që nuk është përdorur pajisja PEI, kjo është çështje tjetër. Prandaj them se kësaj mund ti japë përgjigje një specialist i pajisjeve PEI, se sa ju si administratë.

Z. Y. Merkaj: Ideja është kjo: në qoftë se, ... edhe raporti i pajisjes PEI, ku ka numrat dhe zgjedhësit që kanë votuar, prapë ndodhet në kutinë e votimit dhe kutinë e materialeve zgjedhore. Nëse vendos KAS-si, mundet që të prodhojmë një raport tjetër nga pajisja PEI, por pa emrat e anëtarëve të komisionit të qendrës së votimit.

Z. K. Bele: Dakord! Po, zoti Çefa!

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.05.2021*

Z. E. Çefa: Faleminderit! Me sa kuptoj unë, ne na duhet një mendim i specializuar për këtë pikë edhe unë jam u mendimit si zoti Braho, që duke krahasuar në listën e zgjedhësve, nëpërmjet emrave, duke gjetur ID-në e këtyre personave, dhe ID-në e këtyre duke e krahasuar më tej me të dhënat që ka pajisja PEI, ne na del shumë i qartë fakti nëse këta persona kanë votuar ose nuk kanë votuar. Por gjithsesi për ta administruar, apo për ta ruajtur profesionalizmin, le të themi, e këtij opinioni, ne na duhet që një nga administratorët e procedimit me pajisjet PEI të na japë një përgjigje të kualifikuar që të mos humbim edhe kohë, duke diskutuar për këtë gjë.

Z. K. Bele: Pra për të konkluduar, ...!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Mundem?!

Z. K. Bele: Po!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Vetëm një shpjegim të thjeshtë n.q.s. ma lejoni!

Z. K. Bele: Po, po!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Një nga listat që na është vënë në dispozicion, nga ana e Nën-komisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve, lidhur me të dhënat e pajisjes PEI, po të shikojmë, megjithëse, këto të dhëna janë dhënë thjeshtë me akronime, pra kemi zgjedhësi me akronimin S, L, ...

Z. K. Bele: Zoti Logu, duke qenë se kemi debatuar gjatë lidhur me këto prova, ...

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kjo është e mundur që të behet,

Z. K. Bele: Kemi një ide se si funksionon; unë në parantezë ose dyshoj që qëllimi i pajisjes PEI është të kontrollosh se kush ka votuar dhe kush nuk ka votuar në shkallë vendi dhe të prodhojë një raport të përgjithshëm! Sepse përndryshe në fund të këtyre zgjedhjeve do të dilnin të identifikuar të gjithë abstenuesit e Shqipërisë gjatë këtyre zgjedhjeve, kështu që unë do të mendohesha para se të shkoja të marrja e kësaj prove, megjithatë, pa paragjykuar vendimmarrjen e KAS-it, sugjerimi i zotit Çefa që ne, kur të diskutojmë për provën mund të bëjmë një konsultë teknike me njeri tjetrin dhe nëse është e nevojshme dhe me anëtarë të administratës që mbulojnë këtë proces, por ne, besoj se nga ana procedurale, për këtë provë do të shprehemi në tërësi kur të shprehemi për provat që ju kërkoni të merrni. Nuk e di nëse ka, ... me fal zoti Rusmajli!

Zoti Ilirjan Rusmajli: Jo, unë kam dy pyetje. Një e kam për subjektin ankues që e kërkon këtë gjë, dhe një e kam për administratën. N.q.s., ne futemi dhe hetojmë nëse 300 veta kanë qenë, pra kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe na rezulton që 300 veta kanë marrë pjesë, ne, provojmë vetëm faktin që 300 veta kanë marrë pjesë në zgjedhje! Nuk provojmë dot më shumë se kaq nga prova! N.q.s. futemi dhe hetojmë që 300 veta kanë qenë anëtarë të grupeve zgjedhore, apo jo, dhe na del që 300 veta kanë qenë anëtarë të komisioneve zgjedhore, ne, provojmë vetëm faktin që 300 veta kanë qenë anëtarë të komisioneve zgjedhore. Si na çon prova ne tek vërtetimi i akuzës që këta kanë shitur apo kanë blerë vota?! Si do të na çojë atje? Dhe kjo është e rëndësishme ta dimë si do të na çojë, sepse ne duhet të kujdesemi nder të tjera, edhe për ekonominë e hetimit administrativ. Ne nuk mund të futemi në pyll dhe të presim çdo dru që ka pylli; ne duhet të kujdesemi që të qëmtojmë nga rrethi i provave

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.05.2021*

që kërkojmë vetëm ato që i shërbejnë objektit të hetimit. E para kjo! E dyta, pyetja e dytë për administratën. Këtë historinë e listës së zgjedhësve, të votuesve, atyre që kanë hedhur firmën ose atyre që kanë lënë gjurmën e gishtit, këtë radhë, ne e kemi, d.m.th., KQZ-ja e ka rrahur në çdo palë zgjedhje; gjithmonë ju kanë ardhur kërkesa që partitë kërkojnë listën e votuesve, pra listën me nënshkrime, dhe në dijeninë time, kjo gjë është refuzuar gjithmonë me arsyetimin që lista me nënshkrime mbrohet nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Nëse zgjedhësit votojnë apo jo, kjo është e dhënë personale me ndjeshmëri; a është e vërtetë kjo që po them unë?! E para dhe, e dyta a ka pengesë ligjore që këtë radhë të vihet në dispozicion?!

Z. Y. Merkaç: Nga eksperiencia e KQZ-së është e vërtetë kjo që thatë juve që nuk janë dhënë asnjëherë listat e zgjedhësve, kjo ishte dhe arsyeja që unë këmbëngula kur u hapen kutitë e Beratit, që kërkoja që të mos fotokopjohej lista e zgjedhësve që kanë votuar në qendrat e votimit. Jam i mendimit që edhe kjo është një e dhënë personale dhe nuk duhet tu jepet partive dhe subjekteve.

Z. L. Braho: Do flasë edhe ai nuk po ia marr fjalën! Tani nuk po kërkohet lista e zgjedhësve, të paktën, me sa kuptoj unë. Ne, thjesht po kërkojmë që të konfirmojnë nëse x numër personash kanë votuar apo jo?! Nuk bëhet fjalë as të jepen nënshkrimet as shenjat e gishtave të këtyre personave ndaj pyeta a mundet që administrata thjesht të konfirmojë që këta persona janë votues; pra të lidhur dhe me një vendimmarrje të viti 2013, ku është ngritur një pretendim po nga partia Demokratike, për pavlefshmërinë e zgjedhjeve të bashkisë Korçë, dhe ku debati ishte n.q.s. një numër i caktuar shtetasish, që kishin dalë edhe publikisht në një emision televiziv, ku kishin konfirmuar që kishin marrë pagesë për votën. Dhe, këto janë persona emrat e të cilëve janë bërë publikë, dhe nuk besoj se partia Demokratike ka pretendimet e saj;

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.05.2021*

janë emra që janë bërë publikë, që kanë marrë dhe pagesë, me sa thotë zoti Logu, për të vërtetuar n.q.s. kanë marrë pjesë apo jo?! Këtu s'ka të bëjë me ndonjë të dhënë personale përderisa emrat janë bërë publikë!

Z. K. Bele: Vetëm një sqarim, këta persona në 2013, n.q.s. unë ju kuptoj drejt, bëhet fjalë për hetimin penal apo jo?!

Z. L. Braho: Jo, jo. Në Kolegj Zgjedhor! Në Kolegj Zgjedhor, janë cituar, janë marrë pamjet e emisionit Fiks Fare, janë shqyrtuar, janë marrë si provë nga Kolegji Zgjedhor, dhe ka dalë që kanë qenë diku tek 2-3 persona që kanë votuar dhe numri i këtyre personave nuk kishte ndonjë ndikim në rezultat, dhe nuk ishte marrë në konsideratë në vendimmarrjen e kolegjit; kurse këtu meqenëse bëhet fjalë për 300 persona dhe po ashtu bëhet fjalë që mandati ka lëvizur për 150 vota, mund të jetë relevante. Pra nuk po kërkojmë as se për kë kanë votuar, pra të bëjmë patronazhistin, as të marrim nënshkrimet e tyre! Thjeshtë të dimë a kanë votuar apo jo?! Kaq!

Z. I. Rusmali: E dhëna personale që mbrohet, se tani nuk po kuptohemi me njeri tjetrin, është firma e personave, apo është fakti që ata kanë marrë pjesë në votim apo jo?! Se në kuptimin tim, mund të jem i gabuar gjithë kohës, ka qenë gjithmonë si e dhënë personale është prirja politike e personit, pjesëmarrja ose mospjesëmarrja e tyre në votim, dhe për këtë arsye nuk jepej lista që të mos identifikohet qëndrimi politik i personave; jo mos të kopjohej firma e tyre.

Z. Y. Merkaj: Është fakti, fakti!

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.05.2021*

Z. L. Braho: Unë nuk besoj se Sekretari i përgjithshëm është interpretues i ligjit për të dhënat personale, mund të ishte komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale!

Z. I. Rusmali: Dakord! Unë kërkoja eksperiencën e KQZ-së.

Z. K. Bele: Kolegë! Zoti Braho dhe zoti Rusmajli! ndjesë të dyve! Një minutë të flas unë dhe me pas vazhdojnë secili! Duhet t'ju ftoja që debatin juridik e bëjmë në dhomë këshillimi, sikundër, këtu nuk i vlen edhe procesit dhe hyjmë në një lloj debati nga i cili nuk dalim dot! E kemi gjithë të drejtën të tërhiqemi dhe të rikthehemi me vendimmarrjet përkatëse. Mua, si anëtar i këtij Komisioni, mu duk që kërkesa u artikulua qartë nga kërkuesi se çfarë donte të arrinte me marrjen e provës, por patëm dhe shpjegimin përkatës nga administrata. Ja do të vij të ju zoti Kaziaj. Nëse nuk kemi ndonjë gjë tjetër, do t'ju ftoja që debatin lidhur me këtë, ...

Z. L. Braho: Doja thjesht të sqaroja vetëm diçka në lidhje me pjesën nëse ka votuar ose jo një person dhe nëse kjo gjë është e dhënë personale?! Unë do kuptoja që kjo do të konsiderohej e dhënë personale në zgjedhjet e vitit 2019, ku nga disa subjekte zgjedhore u bë thirrje për bojkot zgjedhjesh, dhe ku supozohej që të gjithë ata që votuan ishin me prirje drejt një subjekti të caktuar politik, ose tek zgjedhjet për referendumin kushtetues të vitit 1998, që po ashtu u bë thirrje për bojkot. Në zgjedhjet e tjera ku kanë marrë pjesë të gjitha forcat politike, nuk besoj se fakti a voton apo jo, tregon për përkatësinë politike të votuesit. Ndaj nuk e konsideroj të dhënë personale. Ky është mendimi im në lidhje me këtë pjesë pastaj vendimmarrja është çështje tjetër.

Z. K. Bele: Po, faleminderit! Ju, sigurisht, keni opinionin tuaj, dhe e respektoj. Zoti Logu, para se të vemi tek zoti Kaziaj! Nga zoti Rusmajli u paraqit në formë pyetje

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.05.2021*

nëse mund të na jepni një shpjegim, si ju mendoni të arrini ose qëllimin e marrjes së provës, në kuptim të përputhshmërisë së asaj që ju pretendoni?! Ngaqë këta persona me këta rekorde që ju thoni, nxjerrja e këtij numri do të ndihmonte çështjen!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Bele ju e thatë shumë mirë, kërkesa e Partisë Demokratike & Aleanca për Ndryshim, është e artikuluar qartë! Ajo mbështetet në nenin 136, pika 1, germa C. Juve ju takon të merrni vendim mbi këtë kërkesë. Faleminderit!

Z. K. Bele: Faleminderit zoti Logu! Zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zoti Bele! Për sa i përket pyetjes që zoti Rusmali i bëri sekretarit të përgjithshëm, unë e ndjej si shqetësim për subjektin politik që përfaqësoj; sjell në vëmendjen tuaj atë që është një shqetësim i imi lidhur me njohuri të pakta që ka zoti sekretar i përgjithshëm lidhur me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë, ...

Z. K. Bele: Nuk mendoj që komentet tona lidhur me njohuritë e thelluara të sekretarit të përgjithshëm,

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo, sepse kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në vendimmarrjen e tij, nëpërmjet, të themi, keq orientimin e këtij komisioni për marrjen e dokumenteve shteruese që ishin në brendësi të materialeve zgjedhore, ...

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.05.2021*

Z. K. Bele: Zoti Kaziaj unë jam shumë mirëkuptues ndaj të drejtës së fjalës, po do tu sillja në vëmendje dhe jeni të lirë të jepni çfarëdolloj opiniononi por kini parasysh që mos komentoni në mënyrë subjektive për ato, ...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: I nderuar zoti Bele! Unë nuk po komentoj. Unë po sjell thjesht në vëmendjen tuaj fakti që na është cunuar marrja e disa dokumenteve, nëpërmjet njohurive të pakta ose keqdashjeve të sekretarit të përgjithshëm, i cili nuk e njeh mirë ligjin, pasi vetë ligji për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë jep hapësirë në të dhëna nëpërmjet nenit 13, në mos gaboj. Pra, një institucion publik i natyrës administruese dhe të themi, edhe vendimmarrës, siç jeni juve, mund të kërkonin nëpërmjet komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale, çdo kërkesë që bëri kolegu im i partisë Demokratike. Ashtu siç keq orienton sekretari i përgjithshëm, duke thënë që, kanë pasur një orientim anëtarët e komisionit të qendrës së votimit që n.q.s. ishte PEI në funksionim, nuk duhet të nënshkruanin tek lista e zgjedhësve. Dhe ky është një keq orientim i qëllimshëm për shkak se nuk vete në përputhshmëri me aktet vendimmarrëse të natyrës administrative të këtij Komisioni, d.m.th. jo tuajin por të KQZ-së në këtë rast, i cili informonte në çdo rast nënshkrimin, prandaj jemi në këtë “derexhe” (situatë), siç thotë populli sepse orientimet i japin me gojë dhe nuk gjejmë as PEI-n dhe as nënshkrimet. Edhe rezultatin final na e nxjerr Sekretari i Përgjithshëm!

Z. K. Bele: Kthehemi tek diskutimi për këtë çështje, për të cilën jemi tani, për shqyrtim! Në fakt edhe një herë do t’ju kërkoja që të mos e përsërisim me këtë lloj qasje, nuk është detyra e sekretarit të përgjithshëm të njohë në detaje ligjin, nuk mendoj se është asnjëri i aftë, ...

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. K. Bele: Në sallë që të ketë njohje të thelluar të çdo neni dhe të çdo ligji. Megjithatë KQZ-ja është organi i Administratës kërkesat që ju keni në rrugë administrative i drejtoni dhe merrni përgjigje shkresërisht. Shumë drejt cituat që ka dhe një Komisioner Shtetëror për mbrojtjen e të dhënave ku mund të ankoheni, unë mendoj që të vazhdojmë me shqyrtimin e çështjes. Shqetësimet që ju ngrini mund të jenë të drejta, por jemi duke diskutuar për këtë provë. Kështu që padashur të bëj debat unë e kuptova shqetësimin tuaj dhe..

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo, dhe unë në kuadër të kësaj e kisha. Në kuadër të një mirëfunksionimi dhe të një thellimi të hetimit administrativ, vetëm kaq zoti Bele.

Z. K. Bele: Ju faleminderit, kemi ndonjë.. po.

Z. E. Çefa: Kam unë një pyetje për zotin Logu. Ju that që ka të dhëna apo infomacione që këta 300 persona të listuar për të cilët ju kërkonit të dini nëse kanë marrë pjesë në votim ose jo, kanë qenë subjekt i shit – blerjes së votës. A mundeni ju lutem ta specifikoni, domethënë këto kanë qenë shitës të votave? Pra, kanë marrë para në këmbim të votave apo kanë qenë persona të aktivizuar në blerjen e votave për llogari të dikujt tjetër dhe të ndonjë subjekti politik? Eventualisht nëse ky është një fakt i ditur botërisht a mund të na thoni si jeni vënë ju në dijeni të këtij informacioni?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit për pyetjen zoti Çefa. Lista me 300 emra që ne i'u kemi vënë në dispozicion, të cilën kurrësesi nuk pretendojmë që të jetë shteruese apo ezauruese, janë persona që kanë emër, mbiemër, qendrën e votimit, adresën, numrin e telefonit dhe shumën e parave që kanë marrë në këmbim të votës së tyre. Po ashtu, në raste të caktuara kanë edhe patronazhistin apo personin, i cili i'u ka shpërndarë para. Ajo që ne duam po themi të provojmë

32

*Zbardhi materialin audio
Johida SALILLARI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

dhe besoj e shpjeguar qartë është që këta persona kanë shprehur vullnetin e tyre në ditën e votimit për subjektin zgjedhor Partia Socialiste në këmbim të parave, shuma përkatëse nga 100 deri në 300 euro. Informacioni dhe ju me të drejtë e thatë është një informacion i bërë publik, mund të gjendet në çdo media online apo media vizive të Republikës së Shqipërisë. Ne jemi vënë në dispozicion të këtij informacioni nëpërmjet medias, por duhet thënë që po ashtu në datën 24 Prill ka një deklaratë zyrtare të Lëvizjes Socialiste Për Integrim, përfaqësuesit janë këtu mund ta konfirmojnë, që e kanë denoncuar këtë rast. Po ashtu, në dijenin tonë për këtë rast është bërë edhe një kallëzim penal në Prokurorin e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Kërkesa jonë vazhdon të jetë e përsëritur që marrja e këtyre provave, të cilat janë nën administrimin e KQZ-së të shihen dhe të vlerësohen edhe në dritën e informacionit që duhet marrë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Krimit dhe Korrupsionit për të provuar faktin. Nëse më pas hetimi i mëtejshëm ka çuar dhe ka dhënë edhe rezultate që mund të jenë të dobishme për këtë proces, faleminderit.

Z. K. Bele: Pra, kemi një kallëzim penal të bërë nga subjekti politik LSI në dijeninë tuaj për këtë çështje apo jo?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Në dijenin tonë dhe sipas deklaratës zyrtare ka edhe një kallëzim penal ku është vënë në dispozicion. Ajo listë që ne i'u kemi vënë ju në dispozicion dhe jemi të bindur që Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar mund të ketë kryer hetime rezultatet e të cilave mund të jenë të dobishme për të hedhur dritë edhe mbi këtë proces administrativ që ne po kryejmë në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Z. K. Bele: Mirë, faleminderit.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit ju!

Zbardhi materialin audio

Jonida SALILLARI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. L. Braho: Zoti Sekretar i Përgjithshëm a mundet që para se ne të arrim në një vendimmarrje apo kërkesë sipas rastit të thërrisni specialistin përkatës që t'i bëjmë pyetje në qoftë se është mundësia për të konfirmuar për disa persona kanë qenë apo jo votues pa hapur materialet zgjedhore vetëm nëpërmjet pajisjeve PEI dhe kryqëzimeve që janë bërë deri më tani?

Z. K. Bele: Pra, pyetje në parim.

Z. Y. Merkaç: Patjetër është e mundur. Administrata është në shërbim të KAS-it. Të marrë vendim KAS-i dhe ne e zbatojmë detyrat.

Z. K. Bele: Pra, jemi tek kërkesat e subjektit PD për marrjen e këtyre provave. Nga subjekti në këtë fazë kemi kërkesë për prova ose shprehni për provat e kërkuara?


Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jemi dakord për ato që ka kërkuar PD për marrjen e tyre. Shpresojmë që t'i vlerësoni me objektivitet.

Z. K. Bele: Dakord, faleminderit. Përfaqësuesi i palës së interesuar nuk është prezent në këtë moment. Atëherë, nëse nuk kemi pyetje të tjera KAS tërhiqet për të marrë vendimin e ndërmjetëm lidhur me provat e kërkuara nga ankuesi.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Para se KAS të marrë vendimin do të vi specialisti që u kërkua nga zoti Braho?

Z. K. Bele: Specialisti na duhet ne për të kuptuar mundësinë teknike të KQZ-së për të marrë apo jo një nga ato prova. Pra, do të diskutojmë ne para se të vendosim lidhur me aspektet teknike të procesit.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankinimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Mos e paragjykoni zoti Bele dhe ne mund të tërhiqemi nga kërkesa nëse nuk ka mundësi objektive për t'i marrë.

Z. K. Bele: Shumë faleminderit, e vlerësojmë..

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Pse nuk bëhet në seancë publike kjo zoti Bele?

Z. K. Bele: Tani se çfarë bëhet në seancë publike.. debati për prova u bë në seancë publike. Diskutimet lidhur me teknikalitete të PEI nuk mendojmë se i shërbejnë seancës. Ne do të mblidhemi përsëri dhe do të relatojmë lidhur me provën pa e paragjykuar.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Sipas rregullores ju shpreheni vetëm në seancë publike, faleminderit.

Z. K. Bele: Atëherë, ju falenderoj që më kujtoni rregulloren nuk kemi ndërmend të shperhemi në prezencë të specialistit. Kemi ndërmend vetëm të pyesim specialistin si ai mund ta ndihmonte procesin. Edhe një herë faleminderit, KAS tërhiqet për vendim.


Rifillon

Ora 11:57

Z. K. Bele: Mirë vazhdojmë, riçelim shqyrtimin e seancës gjyqësore. KAS u konsultua lidhur me kërkesën e subjektit ankues PD, të mbështetur dhe nga LSI për të marrë provat sipas listës që u citua. Me shumicë votash KAS rrëzoi kërkesën për marrjen e këtyre provave, përveç dy provave të cilat janë kërkuar nga 2 anëtarët në mënyrë të posaçme sipas një të drejte që i'u jep kodit. Për interes të publikut po shpejtoj me dy flajë pse KAS zgjodhi ta rrëzonte këtë kërkesë. Pra,

35

*Zbardhi materialin audio
Johida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

subjekti ankues kërkojë të merrte në cilësinë e provës 19 informacione specifike nga insitucione të ndryshme që veprojnë në territor. Subjekti ankues nuk ka bërë një përpjekje për të siguruar paraprakisht provat, sikurse kërkon shkronja “c” e nenit 1 e.. të nenit

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kjo nuk është e vërtetë i nderuar. Kërkoj ndjesë që po ndërhy në këtë moment, por ju duhet të na kishit pyetur.

Z. K. Bele: Dëgjo unë po jap..

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Jo, por ne e kemi bërë këtë që po thoni ju.

Z. K. Bele: Dakord, dakord mund ta vazhdosh pastaj. Pra, subjekti nuk ka bërë përpjekje të themi sikurse kërkon shkronja “c”. Ky është një kusht që duhet të demonstrohet si është plotësuar në momentin që paraqitet kërkesa për marrjen e provës. Për ndryshe dispozita nuk do ta kërkonte që kërkuesi të paraqiste njëkohësisht me kërkesën dhe arsyet pse nuk ka qenë i mundur sigurimi. Informacionet e kërkuara dhe kjo është më kryesorja nuk gëzon cilësinë e provës sipas Kodit të Procedurës Civile dhe për këtë shkak nuk mund të kërkohen si të tilla. Kodi kërkonë ose më saktë garanton të drejtën për të kërkuar prova jo sende që nuk janë të tilla. Llojet e provave janë të përcaktuara, asnjëri prej kërkimeve nuk bënë pjesë në llojet e provave që përcakton Kodi i Procedurës Civile. Kërkimi nga institucionet shtetërore të informacioneve që nuk ekzistojnë në kohën e kërkimit pra, siç janë të dhënat e kallëzimeve penale, por që duhet të prodhohen prej tyre në një kohë të pacaktuar del jashtë tagrave që njeh KAS-i pika 1 dhe pika 2 e nenit 137 e Kodit Zgjedhor. Kërkesat e subjektit ankues janë në fakt kërkesa për të vënë në punë insitucione të ndryshme shtetërore me qëllimin që të hulumtojnë, studiojnë, të analizojnë apo prodhojnë statistikë lidhur me fenomenet e pretenduara nga ana e subjektit ankues. Po e theksoj nuk janë dhe nuk mund të

36

Zbardhi materialin audio

Johida SALILLARI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

merren si prova për qëllim të këtij procesi. Arsyetimin shterues lidhur me këtë vendim të ndërmjetëm të KAS-it do ta gjeni në këtë vendim ashtu siç edhe në vendimet paraardhëse ku janë gjykuar çështjet e pavlefshmërisë. Për të vazhduar me kërkesën e 2 anëtarëve për marrjen e 2 provave, njëra nga të cilat është kryqëzimi i PEI-it pra, do t'i kërkohej Administratës të prodhojë kryqëzimin e PEI-it për të sqaruar dhe për të ndihmuar procesin. Na rezulton që ky informacion nga pikëpamja administrative është tashmë e gatshme. Ne e kemi në tavolinë. Nuk e di nëse i është vënë gati subjekteve? Dakord, faleminderit..

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Subjektet nuk e kanë i nderuar.

Z. K. Bele: E keni këtë?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po e kemi.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ndërkaq në këtë proces ndyshe nga të mëparshmit u kërkua dhe marrja e një prove që është identifikimi i një numri të caktuar zgjedhësish që zoti Logu e citoj 300 zgjedhës. Në fakt doja të bëja vetëm një sqarim. Nga një verifikim paraprak i kësaj liste ne na rezulton që nuk janë 300 janë rreth 150. Numri i saktë do të identifikohet nga Administrata në eventualitetin që do t'i kthej përgjigje kësaj kërkesë. Të 2 anëtarët mendojnë se kjo i vlen dhe si material zgjedhor duhet të merret. Do të paraqitet kërkesa paraprake siç e kemi bërë procedurën. Do t'i lutesha KQZ-së që ta verifikonte krahas mundësisë teknike edhe cakun ligjor të plotësimit të kësaj kërkesë. E theksoj shumica mendon që nuk mund të merret informacioni për zgjedhësit nëse kanë votuar apo jo. Megjithatë kjo është një gjë që ju do ta vlerësoni sipas kërkesës. Në këto kushte duke qenë se ne jemi para një kërkesë që kërkonë një kohë të caktuar për t'u adresuar ne sipas procedurës do të procedojmë me pezullimin e kësaj seance deri në marrjen e kësaj prove dhe pastaj në vazhdim do

37

Zbardhi materialin audio

Jonida SALILLARI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

të jemi në.. do të vazhdojmë me procesin tjetër në rradhë mbas një kohe të shkurtër. Në listë është Shkodra. Shoh zotin Logu që ka një insistim besoj për ndonjë sqarim procedural..

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Bele..

Z. K. Bele: Doja të mbaroj me dhënien e këtij informacioni, po të lutem sepse nuk duam të presim fjalën.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit, ju that po bëjmë ndryshe po themi nga praktika që janë ndjekur nga ky Komision. That që po bëjmë edhe për hir të interesit publik një shpjegim të vendimit, përmbledhje po themi shkurtimisht së vendimit për të refuzuar marrjen e provave. Do të kërkoja, sigurisht që vendimin tuaj ne nuk e ankimojmë në KAS pra, nuk mund t'i themi KAS-it që po ankimojmë vendimin që sapo morët, por për hir të transparencës me opinionit publik siç edhe ju e that. Të informoj edhe anëtarët e KAS-it, por edhe opinionit publik që Partia Demokratike në datë 15 Maj mbase është mangësi që po themi etj., etj., por në datën 15 Maj 2021 Partia Demokratike i'u ka drejtuar 100 kërkesa për informacion 100 organeve të Administratës Publike të Republikës së Shqipërisë. Pra, Partia Demokratike e ka ezauruar rrugën po themi administrative të dërgimit të kërkesave për informacion. Thënë këtë i nderuar sigurisht që koha është e shkurtër. Koha në të cilën do të shqyrtoheshin kërkesat tona ankimore nuk do të ishte, nuk do të priste po themi që ne të merrnim këtë informacione, të cilat ne akoma nuk e dimë nëse do të na jepen, sepse deri në këto momente nuk na janë dhënë. Sa i përket pikës 2-të dhe e kam shumë shkurtimisht, ne mendojmë që kërkesat tona bazohen tek neni 137 pika 1 që thotë.. shkurtimisht.

Z. K. Bele: Zoti Logu ne vendosëm që kjo kërkesë për shumicën nuk ka bazë ligjore.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*


Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: I nderuar unë nuk po kërkoj që ju të ndryshoni vendimin.. po e bëjmë të 2 palët për transparencë apo? E kam shumë shkurt.

Z. K. Bele: Nuk ja vlen.. dëgjo më fal, dakord do të lë ta përfundosh, por ki parasysht që mos të konfuzojmë edhe palët sepse do të shkojmë dhe në fund të procesit do të ketë ndonjë ankim, nëse ka të tillë pa e paragjykuar vendimmarrjen që do t'i drejtohet Kolegjit. Sepse po folët ju dhatë një saparim mbase do të duhet të bëj dhe unë një sqarim. Kjo seancë e arrit qëllimin dhe konkluzionin. Ne do të vijmë përsëri për Durrësin, ju ishit i qartë për mua në ato shpjegime që dhatë për palët në proces. Kështu që për të vazhduar dhe për ekonomi, sepse kemi seancën tjetër mendoj që seanca..

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: I nderuar ne.. domethënë këto sqarime shkurtimisht i kisha. Nuk do të zgjatesha. Do të doja vetëm po themi një citim të shkurtër, por besoj..

Z. K. Bele: Po citoje.. po e shpjegon si relator.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Vetëm këtë gjë.. neni 137 thot: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në rastin konkret KAS-i, u kërkon organeve të Administratës Publike të vënë në dispozicion informacione, dokumente ose çdo provë tjetër. Nga ana tjetër i ndëruar duke qenë se jemi akoma nuk është mbyllur hetimi administrativ Partia Demokratike, subjekti zgjedhor Partia Demokratike Aleanca Për Ndryshim i kërkon Komisionit të Ankimeve dhe të Sanksioneve t'i jepet kohë për të depozituar 100 kërkesat tona për informacion dhe ne do të përsërisim kërkesën tonë për marrje provash duke qenë se jemi akoma në procedur administrative.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. K. Bele: Atëherë, zoti Logu..

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Në çelje ne jemi akoma në hetim administrativ, ndjesë.

Z. K. Bele: Jam dakord, ju do të vini përsëri në seancë paraqiteni atë kërkesë tuaj dhe patjetër që çdo letër që ju sillni, çdo dokument do të administrohet sipas ligjit. I'u kujtoj që kemi dhe 7 çështje të tjera, 6 ndoshta që janë.. që Partia Demokratike ka bërë të njëjtën kërkesë për pavlefshmëri duke kërkuar marrjen e të njëjtave prova. Pra, argumenti ligjor dhe prova e re që ju pretendoni se i vlen vendimmarrjes tonë do të shqyrtohet në këto ose do të vi në vëmendjen tonë në këto procese të ardhshme. Gjithsesi kur të çelim seancën, sepse ne e deklaruar të mbyllur seancën. Thjesht po bëjmë sqarime për të pasur vullnet të mirë përpara publikut. Në vazhdim të seancës ju mund ta sillni këtë provë dhe ne çmojmë nëse ka rrethana që e riçelin shqyrtimin administrativ për shqyrtimin e saj. Faleminderit zoti Kaziaj.. do të mbajmë balancën midis?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po patjetër, të drejtën e fjalës zoti Bele pa..

Z. K. Bele: Asnjëherë nuk e pengoj.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Domethënë ju that që sipas jush nuk përbënë provë? Pra, ju kemi vendosur të zhbëni nenin 137 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 232 të Kodit të Procedurës Civile?

Z. K. Bele: Dëgjo, ligjin ne e lexojmë në mënyra të ndryshme këtu nuk është debat juridik ka një vendim. Vendimi u morrë me shumicë dhe ju falenderojë.. ligjënesi..

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po, por pozita sinqerisht..

Z. K. Bele: Ta mbaroj..

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo po flas unë. Ta mbaroj unë një sekond.

Z. K. Bele: Tani debat juridik.. ne nuk jemi në auditor.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Nuk po e bëj debat juridik po e bëj debat parimor që..

Z. K. Bele: Jo dëgjo, nuk preferoj të të mbyll mikrofonin, të lutem më lërë ta mbaroj..


Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po nëse do të ma bëni bëjeni.

Z. K. Bele: Atëherë, ne si 3 anëtarë vendosëm. Ligji i ka dhënë një të drejt ekskluzive 2 anëtarëve, të cilët mendojnë që kjo provë duhet marrë dhe jemi në këto kushte. Është e pafrytshme që të më lexoni kodet.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Këtë të drejt e keni dhe ju jo vetëm 2 anëtarët. Mund të bëni dhe ju iniciator për marrjen e provës.

Z. K. Bele: Doni të lexoni nenet e kodit?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo nuk dua të lexoj nenin e kodit, sepse e njoh shumë mirë kodin. Ashtu siç njoh shumë mirë dhe procedurën civile që ju that që keni shkelur me të dyja këmbët. Sepse marrja e provës nga të 3-ët është



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

kompetencë e këtij Komisioni dhe duhet ta marri. Të gjitha provat që tha kolegu i Partis Demokratike.

Z. L. Braho: Zoti Bele meqenëse ju bëtë transparencë për vendimmarrjen e shumicës dhe këtu u bë debat. Është normale që vendimet nuk debatohen, vendimet ankimohen dhe këtu unë jam shumë dakord me ju. Mbase ne si pakicë duhet shprehim një arsytim të shkurtër pse ne ishim pro pranimit të kërkesave të subjektit zgjedhor Patia Demokratike. Nuk e di nëse zoti Çefa do ta citojë ai apo mund ta citoj unë? Atëherë, për ne si pakicë ato kërkesa duhet të pranoheshin në zbatim të nenit 137 të Kodit Zgjedhor dhe janë pikërisht për qëllim për transparencë për procesin zgjedhor. Ne anëtarët e pakicës mendojmë që procesi zgjedhor nuk është vetëm dita e zgjedhjeve dhe deri në administrimin përfundimtarë të tabetave përmbledhëse, por procesi zgjedhor fillon që më parë. Madje me marrëveshjen e arritur në këshill politik është shumë e rëndësishme që të hetohet për transparencë e gjithë periudha. Sidomos periudha 4 muaj para ditës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Të gjitha kërkesat që Partia Demokratike kishte bërë apo herë tjetër dhe Lëvizja Socialiste Për Integrim i shërbenin pikërisht kësaj pjese. U sollën indiciet e nevojshme për ne si anëtarë pakice në mënyrë që ne t'i kërkonim ato prova. Për ne ato nuk janë prova të reja janë thjesht prova shkresore që Institucionet Shtetërore ndaj të cilave ishin kërkuar duhet t'i administronin dhe t'ia paraqisnin KAS-it në rast se KAS do të dakordësonte me shumicë votash që t'i merrte. Fakti që nuk u arrit dot shumica e votave me argumentat që zoti Bele i citojë në mënyrë të përmbledhur jemi sot në këtë vendimmarrje që nuk mundet që të hidhet transparencë për atë pjesë. Kjo është arsyeja se pse ne kemi qenë pro.

Z. K. Bele: Faleminderit, seanca mbyllet vazhdojmë me shqyrtimin e seancës së radhës, e cila është kërkesa ankimore për rrethin Shkodër. Vendosim të fillojmë në 12:30? Nuk e di zoti Lako, se ju jeni realtor?

42

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Mund të na jepet pak më shumë kohë, ora 13:00?

Z. K. Bele: Më fal, kemi palë të tjera që duhen njoftuar?

Z. Y. Merkaç: Po, ndoshta Partia Socialiste.

Z. K. Bele: Dakord, besoj se njoftimi realizohet. Në orën 13:00 mblidhemi për të vazhduar me Shkodrën.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*

